



KOMUNA E KLINËS  
KUVENDI I KOMUNËS  
01. NR. 06-2.111 2017  
KLINË, 24.2.2017

## PROCESVERBAL

### I SEANCËS SË RREGULLT TË II-të TË KUVENDIT TË KOMUNËS, MBAJTUR, MË 24.2.2017, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK, drejtorë të Ekzekutivit, Përfaq. i Policisë, komandanti Rexhë Berisha, përf. të KFOR-rit, përfaq. të OSB-së, Zyra Ligjore, Zyra e Auditimit, Zyra e Prokurimit, Zyra e komuniteteve, OJQ “Koha”, mediet etj.

Kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, fillimisht hapi mbledhjen e rregullt të KK të Klinës, i cili i për shëndeti të pranishmit dhe iu uroj mirëseardhje në këtë seancë të KK. “Para se ta bart fjalën te Kryetari Bashota, desha vetëm dy informata për t’i ndarë me ju, e para sot kemi planifikuar se kemi një rend të ditës pak më të ngjeshur, një pauzë prej orës 12 – 13, dhe e dytë që për deklarimin e pasurisë e keni secili nga një kopje të informacionit që duhet brenda muajit mars duhet të bëhet deklarimi juaji i pasurisë. Është proces i rregullt vjetor që zyrtarët e lartë të deklarojnë pasurinë”, theksoi Kryesuesi Ibishi, i cili fjalën e barti te kryetari i Komunës, Sokol Bashota.

**Sokol Bashota**, tha se dëshiroj që AK të Klinës t’i propozoj që në pikën, Të ndryshme, të gjithë se bashku të bëjmë një deklaratë mbështetjeje për kryetarin e AAK-së, z. Ramush Haradinajn, i cili padrejtësisht është i ndaluar në Francë dhe t’u bëjmë thirrje të gjithave institucioneve të vendit dhe ndërkombëtare që, thjesht, sa më shpejt të lirohet nga ajo masë. I bashkëngjitmi shumë asambleve, subjekteve politike, shumë institucioneve, të cilat kanë bërë një deklaratë mbështetëse për të, dhe besoj që është nderi i kësaj asambleje që t’i mbështes të gjithë ata të cilët padrejtësisht edhe sot e kësaj dite po përballen me diçka që realisht nuk i përket domethënë domenit të drejtësisë. Prandaj, në pikët, Të ndryshme, kisha ftuar GP që të diskutojnë rreth kësaj, ku përmes përfaqësuesve të AAK-së e kemi marrë një bazë të një deklaratë, në qoftë se ju jeni në dakord për ta nxjerrë një deklaratë të përbashkët kisha thënë që të dalin nga grupet politike, të gjitha së bashku, ta këqyrin, nëse kanë diçka për të hequr apo shtuar, janë të lirë dhe në fund ta sjellin deklaratën në Kuvend për miratim”, ka konstatuar kryetari Bashota.

**Kryesuesi Ibishi**, ftoi kryetarët e grupeve kuvendare për t’u prononcuar rreth kësaj çështjeje që kryetari e ngrehu, si pikë e 11, në Të ndryshme, kurse pika, Pyetje – përgjigje postohet në të 12-ën.

**Halil Desku (PDK)**, tha se e mbështes propozimin e kryetarit z. Bashota, edhe njëherësh shprehim respektin dhe protestën tonë, pse mbahet padrejtësisht z. Haradinaj, edhe jemi të gatshëm ta mbështesim dhe ta përpilojmë atë deklaratë.

**Arben Limani (LDK)**, edhe ne si grup i asamblistëve të LDK-së e mbështesim kërkesën e Kryetarit të Komunës dhe nëse deklarata nuk është e gatshme bashkërisht jemi të gatshëm që ta përpilojmë.

**Tunë Dedaj (AAK)**, tha se në emër të grupit të AAK-së kisha për t'i falënderuar të gjitha grupet, edhe gjithë asamblistët që dalin në mbështetje të fuqishme për z. Ramush Haradinaj, i cili padrejtësisht po mbahet në Francë.

**Ndue Shabanaj**, tha se gjithashtu jam unë bashkë me këshilltaren me të cilën jam afër këtu, në mbështetje të kësaj deklarate. “Dhe, natyrisht, ndoshta na duket pak e vonuar, mirëpo më mirë tash se sa të kalojë pa e aprovuar. Ndikimi i këtyre deklaratave të aprovuara edhe të protestave të ndryshme na po e dimë çfarë është deri tash, por urojmë që vërtet të dëgjohen edhe këto deklaratë e këto protesta dhe të gjitha këto pakënaqësi të krijuara jo nga një subjekt politik, por nga gjithë populli i Kosovës për mbajtjen e padrejtë të liderit të AAK-së në Francë. Faleminderit dhe jemi në përkrahje të deklaratës”, shtoi prof. Shabanaj.

**Avni Gashi (Grupi 3 Plus)**, tha se edhe ne në emër të Grupit 3 Plus e mbështesim Deklaratën për Ramush Haradinajn, i cili po mbahet padrejtësisht në Francë.

Vuri në miratim rendin e ditës me plotësimin rreth Deklaratës për Ramush Haradinajn.

**Me 22 vota për 1 abstenim u miratua ky**

## **RENDI I DITËS**

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Komunal të menaxhimit Financiar për periudhën janar – qershor 2017,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit për vitin 2017,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-rregullores komunale për menaxhimin e Mbeturinave,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2017-2021,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit komunal të Integritetit 2017-2019,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për iniciimin e procedurës për vënie në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe taksa komunale (dhjetor 2014),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për iniciimin e procedurës për hartimin e Hartave Zonale për Komunën e Klinës,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit nga DKRS për subvencionimin e katër klubet sportive të Komunës së Klinës,
11. Nxjerrja e një deklarate mbështetëse për Ramush Haradinajn, i cili mbahet padrejtësisht në Francë,
12. Pyetje – përgjigje nga këshilltarët e Kuvendit.

**Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.**

Kryesuesi njoftoi për një arsyetim të mungesës, për z. Avni Hoti, i cili është i sëmurë dhe nuk mund të marr pjesë në këtë seancë.

**Fadil Gashi**, tha se te arsyetimi i mungesave desha vetëm shkurt, më lejoni të kthehem mbrapa: “Në një seancë që kemi mbajtur jashtë kalendarit të miratuar, që ju e dini dhe keni qenë të njoftuar, Kryesues, Enver Gashit nuk i ka shkuar materiali në adresë elektronike dhe tash mëditja iu është hequr pa të drejtë, sepse njoftimin nuk e ka pasur, edhe e kam njoftuar këtë seancë prej këtu se nuk e ka materialin, edhe nuk e di, atë ditë nuk kishim mundësi për të komunikuar në telefon. “Është mirë për të pasur parasysh kur bëhet me defektin tuaj. Të mos jetë kjo që unë po ia mbaj zhagin ndokujt, por le të jetë parim te arsyetimi i mungesave. Nëse e kemi arsyetuar bashkërisht në këtë seancë, atëherë s’ka pasur arsye për t’u hequr kjo mëditje. Me mirëkuptim po e them”, tha anëtari Gashi.

## **Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar.

**Skënder Merturi**, pati vërejtje rreth procesverbalit të seancës së kaluar. “Te faqja 11: “Skënder Merturi ka një sqarim: “Dua të falënderoj drejtorin e Urbanizmit, z. Baki Gashi, për pyetje dhe shpjegime.” Pyetjen nuk e ka bërë Bakia, por pyetjen e kam bërë unë, shpjegimin e ka dhënë drejtori. Vetëm kjo për “pyetjen” dhe “shpjegimin” le të përmirësohet, të tjerat janë në rregull”, theksoi anëtari Merturi.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar, me plotësim – ndryshimin e anëtarit Merturi.

## **Me vota unanime (24 vota) u miratua procesverbali i seancës së kaluar.**

## **Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Komunal të menaxhimit Financiar për periudhën janar – qershor 2017.**

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës. Fjalën e barti te drejtori i DFEZH, z. Ramiz Rrusta.

**Ramiz Rrusta**, raportoi rreth Raportit Komunal të menaxhimit Financiar për periudhën janar – qershor 2017.

“Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar – dhjetor 2016 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Siç shihet nga tabela më lartë buxheti sipas SIMFK për janar- dhjetor 2016 është më i vogël për rreth 0.17 % se buxheti për periudhën e njëjtë të vitit 2015. Buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2016 në vlerë 8,376,332.94 € është 94.11 %, e buxhetit në SIMFK, për 2016. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 7,511,739.25 € (99.95 % në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake janë shpenzuar 522,829.15 € (50.85 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2016), nga të hyrat e bartura janë shpenzuar 196,118.63 € (94.97% në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura), nga participimet e qytetarëve janë shpenzuar 31,362.00 € (85.96% në raport me mjetet nga participimet e qytetarëve), nga donacioni i Save dhe Children janë shpenzuar 63,488.21 € (100% në raport me buxhetin nga ky donacion), nga donacioni i USAID janë shpenzuar 44,795.70 € (100% në raport me buxhetin nga ky donacion), nga donacioni i IOM janë shpenzuar 6,000.00 € (100% në raport me buxhetin nga ky donacion). Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 8,376,332.94 € nga Granti qeveritar janë shpenzuar 89.68 %, nga të hyrat e vitit 2016 janë shpenzuar 6.24 %, nga të hyrat e bartura 2.34 %, nga participimet e qytetarëve 0.37% dhe nga donacioni i Save dhe Children 0.76 %, nga donacioni i USAID 0.53%, nga donacioni i IOM 0.07%. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2016 shpenzimet në total në vlerë 8,376,332.94 € janë më të vogla për rreth 2.7% se shpenzimet e vitit 2015 që ishin 8,611,908.24%. Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2016 në vlerë 8,376,332.94 € për paga dhe mëditje janë shpenzuar 5,674,867.65 € (74.75 % e shpenzimeve), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 606,417.19 € (7.24% e shpenzimeve), për shërbime komunale 161,095.48 € (1.92 % e shpenzimeve), për subvencione 61,655.63, € (0.74 % e shpenzimeve) dhe për kapitale 1,872,296.99 € (22.35 % e shpenzimeve). Shpenzimet në periudhën janar- dhjetor 2016 në vlerë 8,376,332.94 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2015 në vlerë 8,611,908.24 € janë zvogëluar rreth 2.74%. Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë rritur 1.87%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë zvogëluar për 2.22 %, shpenzimet për shërbime komunale janë zvogëluar për 5.43 %, shpenzimet për subvencione janë zvogëluar për 22.45 % dhe shpenzimet për kapitale janë zvogëluar për 13.76 %. Të hyrat e realizuara në periudhën janar-dhjetor 2016 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak: Tatimi në pronë, janar – dhjetor 2016, 297,767.00 ose 12.14 për qind më lart; taksat për rrugë, 62,770.00 ose 7.20 për qind; urbanizëm 57,066.53 ose 6.54 për qind, certifikata të lindjes 23,094.50 ose 7.66 për qind; certifikatat e kurorëzimit 8,088.00 ose 24.93 për qind; certifikata të vdekjes 922.00 ose 67.03 për qind; të hyra tjera 6,281.00 ose 24.38 për qind; taksat administrative 6,728.95 ose 17.08; participim- shëndetësia 24,843.60 ose 6.62 për qind; participimet – qytetarët 21,100.00 ose

60.05 për qind; Gjeodezia & Kadastër 64,954.00 ose 6.62 për qind; gjobat nga trafiku 34,206.50 ose 14.35; gjobat nga gjykatat 107,970.00 ose 0.82 për qind; gjithsej 872,020.09 ose 2.88 për qind. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar - dhjetor 2016 dhe ndryshimi me vitin 2015: shpenz. tjera te udhët. zyrt. brenda vendit, 11,884.42, ndryshimi 14,457.73 euro, shpenzimet jashtë vendit 125.4 euro, ndryshimi 125.40 euro; shpenz. e telefonit mobil 21,813.01 euro, ndryshimi 2,792.85 euro; karburantet për vetura 48,276.80 euro – ndryshimi 41,676.84 euro; riparimi I automjeteve 37,739.36, ndryshimi 16.176.87 euro; mirëmbajtja e shkollave 39,211.44 euro (21.329.55 euro); dreka zyrtare 9,539.59 euro (7,926.98 euro); pasuritë jofinanciare 1,8762,296.99 euro (298,852.04 euro; totali I përgjithshëm 1,872,296.99 euro (298.852.04 euro). Nga kjo pasqyrë vërehet se te disa kategori kemi ulje të shpenzimeve, që kanë qenë pak më të ndjeshme, si te shpenzimet e telefonisë mobile, shërbimet kontaktuese, furnizimet për zyrë, karburantet për vetura, kemi një ulje të këtyre shpenzimeve gati për 50 për qind, mirëmbajtja e riparimeve të automjeteve, drekat zyrtare, që kemi një ulje për afër për 8 mijë euro dhe disa kategori të tjera të shpenzimeve etj.,” ka konstatuar drejtori Rrusta, i cili në vijim ju tha anëtarëve të asamblesë se i keni shifrat përpara dhe jam i gatshëm që të përgjigjem në pyetjet e juaja”, ka konstatuar drejtori Rrusta

**Arben Limani**, tha se ne si grup i asamblistëve të LDK-së sa herë që ka shkuar tendenca në zvogëlim të shpenzimeve vazhdimisht e kemi vlerësuar si pozitive edhe aty ku janë zvogëluar shpenzimet. “Kemi vërejtur, domethënë te shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, që ka pasur zvogëlim të shpenzimeve, po ashtu edhe te karburantet për vetura është tendencë e zvogëlimit, edhe te shpenzimet telefonike, mirëpo ka pasur rritje te kategoritë tjera të shpenzimeve. Për shembull, këtu e kemi vërejtur dhe e kemi precizuar edhe si ankesë edhe më herët, domethënë shpenzimet për blerje të kompjuterëve, diku sipas kësaj evidence janë 16 841,64 euro shpenzimet për blerje të kompjuterëve, kështu është edhe në këtë evidencën në raportin që ka bërë Drejtoria e Financave. Gjithashtu, tek vendimet e gjykatave, nuk e di Drejtoria e Financave qysh posedon me këtë çështjen në ndarje, mirëpo e ka precizuar dy herë, vendime të gjykatave. Domethënë në një vend është 3 106.10 euro pagesa për vendime për gjykatë, edhe në një vend tjetër është 91 298.76 euro. Diku që del vetëm pagesa për vendime të gjykatave 107,970.00 euro. Gjithashtu, Drejtoria e Financave kishte qenë mirë që në seancën e ardhshme, që sot nuk e ka të saktësuar këtë, ta sqarojë subvencionet që jepen mbi entitetet publike dhe jopublike. Mundësisht të na sigurohen listat e këtyre që u jepen subvencione te entitetet publike dhe jopublike. Gjithashtu, te kategoria, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, domethënë vërehet një rritje prej mbi 16 176.87 euro, domethënë në krahasim me vitin paraprak. Edhe mundësisht nga Drejtoria e Financave një sqarim rreth qirasë për ndërtesat që është evidencuar këtu te shpenzimet, domethënë për çka paguan Komuna qira, për cilat objekte paguan atë qira, që është evidencuar si rritje në këtë vit”, ka theksuar anëtari Limani.

**Tunë Dedaj**, tha se desha ta them se ne si grup i AAK-së e kemi shqyrtuar edhe e kemi parë, edhe t’ju them të vërtetën jemi gëzuar që ka pasur ulje të shpenzimeve për një shumë bukur të madhe në shumë shërbime. “Po ajo që na shqetëson neve është te vendimet e gjyqit, ku thotë pagesat në vendimet gjyqësorë 91 298 euro, kjo na shqetëson neve si grup. A ka kjo Komunë juristë që i vëren këto gjera dhe të mos lejojë që të shkojnë këto dënime kaq të mëdha, që është shumë bukur e madhe, që i kanë marrë gjykatat prej buxhetit të Komunës”. ka shtuar anëtari Dedaj.

**Skënder Merturi**, tha se fillimisht më duhet të përgëzoj drejtorin për angazhimin që ka bërë dhe po vërehen këto uljet, edhe i gëzohem faktit që ku ka ulje të shpenzimeve që çdo herë i kemi quajtur shpenzime të luksit, po vërehet një ulje, është mirë që ka ulje. “Por, për mua mbeten shqetësuese dy gjera: e para, këto vendimet e gjykatave ato që i kemi përmendur edhe në KPF, e para dhe e dyta shqetësuese te riparimi i automjeteve, që tash po dihet që është riparuar automjeti i kryetari, edhe mbasi është edhe kryetari këtu po shfrytëzoj rastin ta bëj një pyetje, ndoshta kryetari apo ndokush prej drejtorëve kishte qenë mirë për të na dhënë shpjegimin mbase paguar ato mjete, ajo shumë aq e madhe për riparimin e veturës së kryetarit, ku gjendet vetura e Kryetarit, përkatësisht pse nuk është këtu mbase janë paguar gjitha ato mjete. Do të kishte qenë mirë të na jap një shpjegim ndoshta kryetari ose dikush prej drejtorëve. Edhe e mbështes, e tha edhe Arbeni, për ato entitetet publike dhe jopublike që ka rritje, është mirë që në seancën e ardhshme drejtori të na sjell një listë me ato që u janë dhënë”, ka konstatuar anëtari Merturi.

**Lorenc Marleku**, tha se e tha edhe më herët Tuna, vërehet se janë reduktuar disa shpenzime, por unë e pyes drejtorin, për shembull, te mirëmbajtja e shkollave, 21, 000 euro këtë vit më pak, a nuk janë mirëmbajtur shkollat apo nuk ka pasur nevojë që të mirëmbahen, kjo është një diferencë e madhe, te 21, 000 euro. “Për shembull, edhe te disa kategori tjera, të mos e ripërsëris tash edhe gjykatën, domethënë edhe mirëmbajtja e automjeteve, prapë ka 16 mijë euro etj. Domethënë, kjo shumë që është kursyer, a është kursyer që është dashur për t’u kursyer, apo është shpenzuar enorme e vitit 2015, domethënë, a ka pasur keqpërdorime dhe a ka marrë ndokush përgjegjësi për atë punë”, ka konstatuar anëtari Marleku.

**Rasim Millaku**, tha se meqenëse ndaj grupit tim parlamentar kam qenë kritik gjatë gjithë kohës për shpenzimet, nuk mund ta kaloj këtë raport pa e përshëndetur për racionalitetin mjaft të mirë të shpenzimeve. “Domethënë, vërehet që edhe kontributi i PDK-së ose grupit tonë parlamentar ka bërë që këto shpenzime të jenë shumë më rationale. Unë vetëm e përshëndes këtë”, ka shtuar anëtari Millaku.

**Ndue Shabanaj**, tha se natyrisht se kjo po i bien përsëritje për shkak se ne e kemi shqyrtuar në çdo tremujor menaxhimin financiar komunal për periudhën tremujore. “Domethënë, gjithmonë kemi pasur angazhimet tona edhe kemi bërë përpjekje ta japim kontributin tonë në drejtim të zvogëlimit të shpenzimeve dhe besoj që ia vlen për ta përshëndetur, edhe kemi arsye në një formë të përshëndesim çdo zvogëlim të shpenzimeve. Mendoj se Ekzekutivi në krye me Kryetarin e Komunës, por edhe Asamblenë Komunale pa dallim nga përfaqësimi politik, me arsye kemi qenë kritikë në shpenzimet që ne i kemi vlerësuar që janë të tepërta dhe më vjen mirë, besoj edhe të gjithëve na vjen mirë që ka ulje të shpenzimeve. Nga ana tjetër, këto që po potencohen, edhe i kemi potencuar disa herë, këto gjobat nga gjykata, që janë në adresë të Komunës së Klinës. Edhe atëherë unë e kam thënë dhe dëshiroj për ta përsëritur të njëjtën gjë, kur e kemi shqyrtuar në kuadër të tremujorit si buxhet financiar, që kam thënë se secili që është përgjegjës për atë pjesë ku Komuna dënohet ose gjobitet nga gjykata, për farë neglizhence, të përcaktohet realisht, edhe përgjegjësia të determinohet, të përcaktohet dhe, natyrisht, Kryetari edhe Ekzekutivi marrin masat për evitimet e këtyre parregullsive që janë lidhur me pagesat, që realisht duhet t’i bën Komuna e Klinës. Kjo është për shqetësim dhe për pjesët tjera unë besoj se kemi arsye të gjithë të jemi në përkrahje edhe t’i gëzohemi një uljeje të shpenzimeve në shumë kategori”, ka shtuar prof. Shabanaj.

**Fadil Gashi**, tha se e tha edhe drejtori, është e vërtetë se për shpenzime kemi debatuar edhe në KPF, mirëpo po me duket se as aty, as sot nuk morëm përgjigje për ato që i kemi kërkuar të paktën në KPF. “Ne kemi kërkuar të na sjellët me shkresë, u fol edhe prej një anëtari të Asamblesë Komunale, për shpenzimet fiks të veturës së Kryetarit të Komunës, veç, bile edhe në zyrë e kam potencuar kur kemi shkuar për ta hartuar rendin e ditës. Ne kemi menduar që sqarimin na jep drejtori. Pjesa tjetër, drejtor, ai defekt teknik, që e potencuat edhe ju, neve prapë na ka ardhur njëjtë në material tonin, për të mos themi se krejt materiali na ka ardhur mbrapshtë, edhe tjerët, edhe që janë përzier që s’po dimë se cili me cilin po shkon! Edhe nëse i referohemi, qysh po thotë kryesuesi “ke dalë prej rendit të ditës”, realisht kemi 12 pika të rendit të ditës, edhe me vërejtjen poshtë, fillon me një, Arsyetimi i mungesave, 11, 12 janë vërejtjet. Tash poshtë tregon qysh është materiali, edhe ne e kemi miratuar. Unë jam duke e pritur që kemi për të debatuar për këtë çështje, se veç e kemi miratuar rendin e ditës. Tash në vazhdimësi po shkojmë në këtë mënyrë. Te pjesa e shpenzimeve, edhe në KPF e kemi thënë, e tha Arbeni edhe në emër të grupit. Aty gjithmonë ne kemi kërkuar për t’u ulur, edhe janë ulur ato shpenzime, edhe ne e kemi përgëzuar edhe në KPF, edhe sot. Por, nuk është aq ngushtë te shpenzimet, por është për t’i parë edhe të hyrat. Ne jemi fokusuar të gjithë veç sa po shpenzoni, edhe ne as nuk po pyesim, as drejtorin, as ekzekutivin kah po i grumbulloni? Askush nuk po debaton aty te të hyrat, edhe ku kemi ngecje, edhe ku duhet për t’u angazhuar, edhe ekzekutivi, por në qoftë se ka nevojë mund të implikohet edhe asambleja, domethënë tek të hyrat. Edhe nëse është ai krahasim ose ajo analizë, tash të shihen te participimet, për shembull, edhe tek shëndetësia, që u potencuar aty, krahasuar me shpenzimet, dhe krahasuar me raportin që e bien shëndetësia me numrin e pacientëve, që brenda një viti fiskal kërkojnë ndihmë ose vizitohen aty, nuk po përputhet me participimet që ne i kemi këtu përpara vetes. Ka, edhe pastaj me 2 euro e sa janë ato të mos hyj në detaje, por nuk po na dalin do të thotë njëjtë. Do të thotë është një ndryshim dhe ndryshim jo i vogël, por i madh. Dhe, tash nëse iu referohemi pjesëve tjera, unë kam kërkuar edhe atë ditë prej drejtorit, sepse ndryshimi prej 50 për qind te shpenzimet të karburanteve, është bukur shumë e madhe që duhet marrë në konsideratë. Por, tash ndoshta ia

vlen të them çka u bë, ka rënë krejt niveli i punëve, edhe Komuna e Klinës nuk punon asnjë gjë, sepse për t'i ulur shpenzimet te karburantet e veturave për 10 apo 20 për qind, është aty-aty, por ka një ulje drastike 50 për qind. Prej 41 mijë eurove e tash të bie në këtë nivel, krijon dyshimin se mos ka qenë që në vitet paraprake keni paguar borxhin fushatave që iu keni dhënë naftë njerëzve ose çka ka ndodhur është mirë, jo vetëm për të na dhënë shifrën, pra drejtori është mirë për të na sqaruar, pse ka ndodhur, sepse ne vetëm po shohim shifra, edhe është e mirë që është ulje, ne nuk po e kontestojmë atë, por është mirë për ta analizuar. Te shpenzimet e telefonit nuk e kemi ndonjë ndryshim të madh. Por, kur e marrim edhe telefonin fiks ne kemi qenë gjithëherë 27 - 28 mijë deri në 30 mijë, këtu jemi duke e sjellë. As këtu nuk ka jemi fort të dallueshëm, do të thotë njëjtë, që ju keni ende hapësirë, nëse ka vullnet, akoma mund të ulet kjo shumë, në kuptimin e shpenzimit racional të telefonave se tash disa lloje janë bërë këtu, jo vetëm këtu, por në institucionet publike gjithkund. Janë disa lloje që i ul shpenzimet, po të ketë vullnet. Dhe, për krejt në fund, unë kisha kërkuar që të shihet më shumë sa është niveli i të hyrave, e jo për t'u marrë fort tash. Ne po e shohim që disa kanë rënë në kurs, sa kem i mundësi, sepse edhe te investimet kapitale, nëse iu referohemi te zbritjeve, sepse kemi zbritje në investime kapitale. Tash ajo nuk krahasohet. Nëse kemi zbritje në dreka, është mirë, por nëse kemi zbritje në projekte kapitale, nuk është mirë. Tash nuk shkojnë të dyja për t'u lavdëruar”, ka nënvizuar anëtari Gashi.

**Petrit Palushi**, tha se kam një pyetje për drejtorin, te reklamat dhe konkurset, po e shoh 7 490 euro, desha të di cilës kompani iu kanë paguar gjithë këtë shumë, facebookut apo kujt?

**Sokol Bashota**, tha se drejtori e bëri një raport, duke i lënë mangu edhe tri investime që janë bërë bashkëfinancim me donatorë të huaj, që është rruga e Klinafcit 100 mijë euro me CDF-in, USAID-in, rrugën e Rudicë 50 mijë euro me USAID-in, edhe ndërtimi i dy rrugëve në qyteti me IOM-in, që besoj që kishin me rritë pjesën e investimeve nëse ka zbritje në raportin që përmendi drejtori. “Ndërsa, sa i përket veturës, vetura është e rregulluar, më në fund është gjetur mundësia për ta rregulluar, edhe pse kemi pasur shumë problem. Problemi se pse nuk është vetura këtu për shkak se duhet për t'i marrë targat zyrtare. Edhe unë e kam marrë shkresën prej Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve, se janë kërkuar targat, shtypen diku jashtë Kosovës, jo vetëm për kryetarin e Komunës, por edhe për një ambasadë të vendeve që janë të akredituara për në Kosovë, dhe MPB nuk ka arritur për të bërë pagesat me rregull për këtë vit, për arsye se buxheti këtë vit ka filluar me vonesë. Proceset tenderuese i ka në shqyrtim, nuk janë bërë me kohë, nëse dëshironi po ju lexoj edhe shkresën, që i kemi bërë kërkesë në emër tim QRK-së, pse nuk vinë targat, nuk na është lejuar të marrim targat civile, për arsye se gjithë stafi i automjeteve të Komunës duhet të pajisen me tabelat zyrtare, edhe e kam përkuar pikërisht të njëjtin numër që ka qenë edhe më herët. Ky është arsyetimi, jemi në pritje në momentin kur të vinë tabelat edhe normalisht nuk kam llogari të udhëtoj me veturë personale. Shpenzimet e vogla, për t'ju thënë të drejtën këtu nganjëherë është mirë kur dakordohemi kështu, edhe kur jemi në fokus të gjitha së bashku në shërbim të qytetarëve. Një kontribut të çmuar keni dhënë ju asamblistët në uljen e këtyre shpenzimeve dhe deri diku edhe me presionin e juaj drejtorët e drejtorive me gjithë stafin që kanë arritur ndoshta pak të jenë nën presionin e kritikave për të cilat përherë i kam inkurajuar edhe asamblenë thjesht për të bërë një gjë të tillë, dhe në anën tjetër edhe një vendim i ashpër që kam pasur në BD për shpenzimet, përkatësisht për nacionalitet të shpenzimeve komunale, duke mos neglizhuar për asnjë moment, angazhimet në punë. Ndoshta vetë projektet që janë bërë, që janë kryer në Komunën e Klinës dhe për vetë projektet që po kryhen në Komunën e Klinës, kjo dëshmon më së miri që në Komunën e Klinës po punohet në shërbim dhe në interes të qytetarëve dhe përditë e më shumë veç kemi rritje të investimeve dhe kapitale në Komunën tonë. Por gjithsesi nuk duhet inkurajuar kjo dhe për të pasur mundësi për t'i ulur akoma këto shpenzime, por le të shihet gjithsesi është shumë me interes vërtet edhe të hyrat që i potencoi asamblisti Gashi, të dihet nga po vinë edhe sa do të kemi mundësi për të bërë më shumë, në mënyrë që këto të hyra determinojnë edhe punën e ekzekutivit për arsye se padrejtësisht këtë çështje e kam ngritur edhe në QK, por edhe në MF, se Klina është ngarkuar me të hyra vetanake ndoshta-ndoshta të papërballeshme për mundësitë buxhetore që i ka si komunë për arsye se për vitin e ardhshëm na takojmë diku mbi 1 milion e 30 e diçka mijë euro të hyra vetanake që duhet realizuar Komuna e Klinës dhe që është vërtet gati-gati e pamundshme, por nganjëherë ia kemi dalë dhe të shohim tash që do ta kemi sfidë”, ka konstatuar kryetari Bashota

**Ramiz Rrusta**, iu përgjigj interesimeve të anëtarëve të AK. “Çdoherë e keni dhënë atë kontributin tuaj edhe kur më mirë jam ndjerë kur më keni kritikuar, edhe për raportet që I kemi bërë. “Po nisem prej Arben Limanit, 3, 352 mijë euro është një koeficient i ngritur më vonë dhe punëtori ynë ka fituar përmes gjykatës edhe është një afër 1 mijë euro drejtor në arsim edhe e bën këtë shumën prej 52 euro, ndërsa vlera 91 298.76 është raportuar në çdo tre muaj, sepse ka qenë kompania që ka fituar kontekstin gjyqësor që unë edhe sot e kësaj dite nuk pajtohem që jemi duke pritur nga instance më e lartë në mos po merr vendim në favor tonin pozitivisht. Në seancën tjetër ju sjellim listën për të gjithë ata përfituesit të cilët kanë përfiturat prej subvencioneve. Te mirëmbajtja e automjeteve nuk po flas pasi kryetari veç sqaroi, vetura është paguar dhe Zyra e Kryetarit nuk ka pasur diku afër 900 euro, mjetet tjera I kemi pasur dhe kemi bërë pagesën për rregullimin e veturës. E njëjta pyetje ishte edhe të këshilltarit Tunë Dedaj, për vendimet gjyqësore. Gjithashtu edhe Skenda e bëri të njëjtën pyetje për subvencione, pra do t’ju sjellim listën e përfituesve. Te Lorenc Marleku, dihet fare mirë se janë lëshuar disa shkolla të reja dhe dihet fare mirë te kostoja e mirëmbajtjes kur janë shkollat e reja shpenzimet janë më të ultë dhe për këtë kemi një rënie prej 21 mijë euro. Profesor Ndou e përmendi që në çdo tre muaj është bërë raporti financiar edhe është përcjellë shuma prej çdo tre muaj, por po ju them që ne kemi gjobat të cilat i marrin prej gjykatës që është vlera prej 107 970 euro, tash krahasuar gati po na bien njëjtë, na i kanë marrë afër 100 mijë, na i kanë prurë 107 mijë, edhe gjobat e trafikut diku 34 mijë. Te të hyrat më erdhi mirë që z. Gashi e përmendi që më tepër duhet të merrem se cila është se ku kemi ngecje tek të hyrat, si po realizohen ato të hyra, cilat masa duhet ndërmarrë ne si drejtori e financave, si ekzekutiv që të inkasojmë sa më shumë të hyra, por Kryetari edhe e tha që si Komunë ne nga MF 1 280 00 euro sit ë hyra vetanake është e pamundur të inkasojmë. Te tatimi në pronë diku vetëm 1 200 euro ato që kemi planifikuar nuk kemi pasur mundësi të realizojmë, domethënë diku 99.5 për qind kemi realizuar, por kategoritë tjera, që thuhet çka planifikohet është edhe vështirë të realizohet, sepse nuk varet prej nesh. Është mirë te qiraja e objekteve dhe këto ne si DF të gjitha masat i kemi marrë dhe i kemi dorëzuar te kompetentët, se duhet marrë masa ndaj atyre të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj Komunes. Te çmimi i derivateve kjo mund të jetë edhe si pasojë e lëvizjes së vlerës në treg të naftës dhe kemi parë që dikur nafta ka qenë deri në 82 cent dhe kjo mund të jetë si shkaktar i kësaj pse kemi më pak. Edhe te reklamat, z. Palushi, janë kjo pjesë është e drejtorisë e Administratës, ku i bëjnë ato reklamat e veta edhe është paguar shumë e cila ju përmendët”, ka sqaruar drejtori Rrusta.

Kryesuesi vuri në miratim Raportin. Me 20 votë për, 1 kundër, 5 abstenime u miratua miratuar Raporti Komunal i Menaxhimit Financiar për periudhën janar – qershor 2017.

### **Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit për vitin 2017.**

**Haxhi Ibishi**, fjalën e bartit te zyrtari i Zyrës së Prokurimit z. Abaz Foniqi.

**Abaz Foniqi**, raportoi rreth Planit të Prokurimit për vitin 2017. “Planifikimi i prokurimit për vitin 2017, sic e dini, është një kërkesë ligjore e Ligjit të prokurimit Publik, që duhet të dorëzohet në afatet e caktuara. Afat i që duhet të dorëzohet në Komisionin Rregullativ të prokurimit publik dhe Agjencionin Qendror të prokurimit, është 30 ditë pas miratimit të buxhetit në nivel qendror, dhe është kështu është vepruar. Kjo tabelë që keni përpara është vetëm një tubim i shënimeve nga Njësitë kërkuese ose departamentet e Komunes sonë dhe të harmonizuara me buxhetin e miratuar në këtë asamble, të cilat janë vetëm të grumbulluara për kërkesat dhe nevojat dhe të paraqitura në këtë formular, të cilat ligjshëm është dashur të dorëzohen në AQPK në kohën dhe datën e caktuar. Asgjë tjetër nuk ka vetëm kërkesat e departamenteve apo njësisive kërkuese që dërgohen në Ligjin e prokurimit dhe b buxhetit të miratuar në këtë asamble. Ndonjë krahasim i atyre vlerave është duke i harmonizuar disa çmime të viteve të mëhershme për të dhënë një vlerë, se në të gjitha pozicionet të të gjitha kategoritë kërkohet në formular të jepet një vlerë paraprake ose e menduar. Do të thotë ju e dini që është planifikim, për t’u realizuar duhet mund, duhet punë, duhet pritur vitin për të përfunduar dhe për të shikuar a duhet të realizohen në tërësi këto kërkesa apo edhe më tepër, kemi pasur raste që janë realizuar edhe më shumë duke iu falënderuar edhe donacioneve të ndryshme ose projekteve që Komuna në vite ka përfiturat edhe është rritur edhe gama e numrit të prokurimit ose edhe e vlerave të projekteve”, ka raportuar zyrtari Foniqi.

**Arben Limani**, tha se desha të pyes se i pashë një sërë projektesh të planifikuara nga Zyra e Prokurimit. “Desha të pyes, sa iu ka përmbajtur miratimit të buxhetit që kemi bërë, domethënë ky plan i prokurimit për 2017, edhe ajo çka është shqetësim për grupin tonë të asamblistëve, që vërehet në tabelarin që është dorëzuar, do të thotë te planifikimi i projekteve që do të kryhen, tek datat e parashikuara për realizim të këtyre projekteve janë të zbrazëta, janë kryesisht të padefinuara se kur do të kryhen edhe pse një arsytim është dhënë poshtë aty se e keni dhënë arsyetimin si ZP. Edhe shqetësimin tonë e kemi në lidhje me atë që janë futur që këto projekte të realizohen edhe gjatë fushatave, që ka pasur edhe gjatë kohës kur ka filluar fushata, edhe jemi në vit zgjedhor, domethënë ka pasur projekte që kanë filluar për t’u realizuar edhe në kohën e fushatës zgjedhore. Gjithashtu, ajo çka është vërejtur, domethënë, këtu përmenden planifikime edhe nga dy herë të objekteve të caktuara për rinovim. Shembull, Qendra Sociale, një herë e keni evidencuar si rinovim i lehtë, dhe një herë e keni evidencuar si rinovim i Qendrës Sociale. Gjithashtu, edhe dy herë evidencuar edhe rinovimi i kulmit të sallës së sportit të gjimnazit, domethënë në qershor këtu dhe në qershor më poshtë, domethënë në të njëjtin muaj, por normalisht me shifra të ndryshme. Këto sqarime mundësisht të na jepen nga zyrtarët”, tha anëtari Limani.

**Ndue Shabanaj**, tha se unë e kam pasur një kërkesë në KPF kur e kemi shqyrtuar këtë material. “Edhe përkundër faktit as që është bërë përpjekje për t’u vlerësuar dhe dua për ta ngritur tash gjithashtu në AK si shqetësim timin dhe besoj që e përkrahin edhe të tjerët, formën e komunikimit zyrtar, e cila për mua po çalon edhe çalimet janë të dukshme dhe të patolerueshme. Materialin që kemi përpara, veçanërisht ky është me aq shumë gabime gjuhësore dhe teknike sa vërtet nuk i përkon një niveli të komunikimit me AK edhe më qytetarët përgjithësisht. Këto janë materiale publike, janë burime të informacionit për qytetarët, prandaj unë thërras që këto të jenë në nivel dhe të ndërpritet një herë dhe përgjithmonë kjo formë e papërgjegjshme e komunikimit me AK dhe qytetarët. Dhe ne kemi pasur vërejtje shpeshherë edhe për procesverbalin, edhe materiale tjera, se komunikimi i qytetarit me ne drejtpërdrejt është edhe informimi i tij është përmes procesverbaleve, përmes këtyre dokumenteve që janë publike, edhe këto duhet të jenë në nivel. Këto tjerat që janë pjesë, realisht unë pajtohem me këto se shumica janë në përputhje me ato projektet me prioritet, besoj, edhe kështu me radhë”, ka shtuar prof. Shabanaj.

**Abaz Foniqi**, dha sqarime rreth interesimeve të anëtarëve të AK. “Në sqarimet që do të jap, sidomos te Arbenit, kërkesat janë me vend. Afatet që mungojnë në atë tabelar kushtimisht në fjalinë e fundit jam munduar të jap arsyetimin, sepse janë ato projekte që në buxhetin e Komunës nuk janë të përfshira, por janë kërkesa nga drejtoritë që janë menduar që mund të krijojnë donacione ose mund të mbesin me rishikim të buxhetit pas muajit qershor, që mbesin pas projekteve tjera dhe dëshirat, gjegjësisht nevojat janë që të realizohen. Unë po them nga ajo arsye nuk është mundur t’i vihet data, se ndoshta nuk realizohen, por ka mbetur kërkesë e drejtorive nëse sigurohen mjetet. Ndërsa që u tha “mos janë për fushatë”, unë nuk di të flas politikisht, unë di të them, që ato janë kërkesë, nuk është përcaktuar një datë, sepse nuk ka mjete për momentin kur realizohen, është planifikim. Kjo është ajo që mund të thuhet”, ka shtruar zyrtari Foniqi.

**Sokol Bashota**, tha se i kisha thënë Abazit të mos shqetësohet se ne duam të punojmë, edhe që dhjetë vjet jemi duke punuar kështu, kështu që mos u brengosni shumë ndërmend të ndalemi nuk e kemi së punuari në realizim të projekteve që janë në interes dhe shërbim të qytetarëve. “kështu që edhe pa zgjedhje kemi punuar, kur s’ka pasur fare zgjedhje, kështu mos shqetësohuni fort kur punohet por thoni “mirë se po punoni!”

**Fadil Gashi**, tha se unë e kuptoj edhe Abazin që s’i takon të flas politikisht absolutisht, por te pjesa jonë neve na lejohet, por këtë që po dua ta them as kjo nuk është politike e imja. “Zyra e Prokurimit e ka qenë dashur mirë ose do të kishte për të qenë mirë, para nesh të thotë unë këtë plan që kam bërë për këtë vit jam bazuar në miratimin e buxhetit që keni bërë ju për vitin fiskal që jemi këtë vit, por jo sipas drejtorive, sepse ky alfa dhe omega e ka buxhetin, sepse ne e kemi miratuar. Dhe unë nuk desha fare të flas, por edhe ky edhe kryetari m’i nxorën fjalët gjithqysh. Po t’i referohesh këtyre që ky i ka planifikuar, përjashtoj pjesën e çmimoreve me artikujt etj., ndoshta është shumë e përgjithshme për të gjitha institucionet, edhe një pjesë që i ka centralizuar niveli qendror, nuk po hy, por këtë pjesën e projekteve, a besoni që nuk përputhet me buxhetin që ke kemi miratuar



për projekte kapitale. Aty-këtu po, por përqindja e madhe jo. Dhe tash unë nuk e di nga i ka marrë, a më të fuqishëm janë drejtorët që i kanë dhënë këto prioritete apo ne që kemi miratuar buxhetin si Kuvend me ato projekte që kanë kaluar. A jemi pajtuar apo nuk jemi pajtuar, pak rëndësi ka, me rëndësi që është votuar në Kuvend. Edhe Zyra është dashur për t'iu përmbajtur. Nuk po dëshiroj për ta personalizuar, nuk kam punë me personin. Dhe, këto që janë të paemërtuara: ne e kemi lexuar poshtë, edhe unë e kam lexuar, bile unë jam ithtar për t'i lexuar goxha fort këto të prokurimit. Unë e kam lexuar edhe Raportin e Auditimit, qysh e keni lexuar të gjithë për vitin 2015. Edhe ai tregon se qysh bëhen e çka bëhen, në çfarë mënyre janë bërë, bile potencohet edhe ZP, edhe çështjet tjera. Këto të paemërtuara unë besoj që bashkë edhe me ju e dini qysh fillon procedura e një tenderi. Dhe tash, nëse realisht nuk sigurohen këto mjete, mua po më intereson qysh e bën ti raportin sa është përqindja e implementimit të këtij plani, nëse të mbesin këto pa u realizuar. Ne po paragjykojmë se na gjenden mjetet. Raporti në fund ty të del katastrofik nëse bën raport të implementimit të këtij plani, sepse tash pjesa dërmuese sipas çmimeve po del që nuk mundet të realizohet. Prandaj po ia trasojmë vetes rrugën për ta pasur një raport kthyes që nuk është i implementueshëm për një përqindje bukur të lartë. Kah orientohen ato ne e dimë që orientohen më shumë kah janë anëtarët e PDK-së, është krejt normale, i çojnë andej, mundohen për t'i çuar, por unë besoj se duhet për të qenë të kujdesshëm ju mirë, edhe ti kryetar, edhe krejt ekzekutivi, sepse në një moment ndoshta ndokush pyet për këto shpenzime, pyet për procedurën, pyet edhe për prioritetet, e dhe duhet për të qenë të kujdesshëm, balanconi pak projektet, sepse në komunën e Klinës nuk është vetëm një regjion, në komunën e Klinës nuk është vetëm një grup i njerëzve, por ka qytetarë të Klinës edhe ka prioritete dhe është mirë për t'iu orientuar këto prioritete, jo në një fshat ose në një mes. Unë gjithëherë kam qenë ithtar i implementimit të projekteve kudo që ndodhen janë qytetarë tanë, por nuk jam ithtar për t'iu dalluar qytetarët tanë, edhe nuk jam për t'iu dalluar sipas gjeografisë, as sipas kritereve tjera, edhe po më vjen keq që po potencoj këtu, mirëpo pasi i shohim edhe këto tash të prokurimit, edhe projektet që i kemi kaluar, të paktën një sikur të ishte hyrë që është propozuar. Ju vetë na keni thënë, kanë për t'iu marrë parasysh ato që janë propozuar këtu. I shohim mundësitë, meqë janë të paafatizuar, bëhuni të sinqertë merreni bile 3 apo 4 prej atyre edhe çojani ZP le t'iu inkorporojnë ashtu pa afat, edhe ato pa afat, edhe po që se iu vjen ndonjëherë afati edhe ato le të jenë. Por mos i ndani kështu sepse nuk është mirë. Edhe një kërkesë e kam: ju e patë kur u ndryshuar kjo e participimit e qytetarëve që kanë dalë minus 31 mijë euro më pak se sa vitin paraprak. Edhe kur të kërkonti participim unë jam ithtarë që t'iu kërkohej të gjithëve. Nuk është e thënë sa i ngarkoni. 10 euro po që se i qet një qytetar në çfarëdo projekti, çfarëdo vlere është e mirë, sepse është pjesë e atij investimi. Është turp të shkohet në projektet më të mëdha dhe të mos participojë diku një mes fare, ndërsa një mes bëni përpjekje t'ju merrni shpirtin për të participuar. Participimin përdoreni si kriter për të gjithë ose hiqni për të gjithë. Mos bëni dallime diku në një projekt kërkonti participim, ndërsa në një tjetër jo. Krejt këto po i them në kuptimin më të mirë edhe të përmirësimit. Diçka që investoni në Klinë mos mendoni se neve na vjen rëndë. Ejani investoni ne vetëm kemi për t'ju përgëzuar, por mos bëni përpjekje edhe fort për t'iu përvetësuar, sepse të gjithë nga pak kanë hise, edhe në kërkesa, edhe në propozime, edhe në mesitni, sepse dikush ndihmon për anësh, është burrëri të thuhet se edhe filani na ka ndihmuar pak. Nuk është krejt për t'iu përvetësuar, sepse nuk është krejt punë private kjo punë, as Komuna nuk është organizatë private”, ka konstatuar anëtari Gashi.

**Skënder Merturi**, tha se për ta vërtetuar dhe për ta dëshmuar atë që e thanë Arbeni edhe Fadili, projektet kapitale për 2017 i kam këtu me vete që e ka votuar kjo Asamble, edhe është ky plan i Prokurimit që na ka ardhur që ka shumë-shumë mospërputhje me buxhetin. “Me aq sa e di unë, me aq sa kam parë dhe kam lexuar ligjet, këtu duhet për të qenë të përputhura njëra me tjetrën. Ndonjë shkoputje të vogël po e pranojmë, vetëm mos me u lidhur këto dy dokumente mes vete akoma që katër vjet këtu në asamble nuk na ka ardhur. Është një shpërputhje tepër e madhe mes ZP dhe mes këtij buxheti që ka votuar kjo asamble. Të paktën të jetë një balancim, e para, se shumë gjera i tha Fadili. Edhe e dyta, atë që e tha Kryetari, që sa mirë punon ZP e ka dëshmuar Prokuroria vitin e kaluar që e ka bastisur ZP, si dëshmi dhe si fakt se sa mirë punon ZP në Komunën e Klinës”, ka shtuar anëtari Merturi.

**Tunë Dedaj**, tha se unë desha të them se kur ndërtohet ose kur punohet diku, pa marrë parasysh ku, në cilin cep të Komunës është, unë e përkrahi dhe e mbështeti. “Pavarësisht a është vit elektorale apo nuk është te unë nuk

çon na kandar, është me rëndësi që investimet të shkojnë te qytetarët tanë. Kam një pyetje: janë të parapara 20 mijë euro për mirëmbajtje të rrugëve verore, nuk e di a e ka Gjoka apo Bakia, cili e kanë të paraparë, mirëpo që tre vite që jam në asamble unë asnjë rrugë të rregulluar verore nuk e kam parë në atë zonë nga unë shkoj. Edhe është mirë që është paraparë për t'u mirëmbajtur ato rrugë, janë mirë që janë parapara ato 20 mijë euro, por me të vërtetë nuk po e di nga po shkojnë a ku po punohet. Nuk kam parë, kam dëshirë të shoh. Edhe kam dëshirë nga këta që janë përgjegjës të më thonë këtu punohet ose këtu është punuar. Përndryshe, për vete e mbështes, është diçka e mirë kur punohet për qytetarin", ka theksuar anëtari Dedaj.

**Sokol Bashota**, tha se nuk di po më duket se ne si ekzekutiv jemi duke implementuar vetëm vendimin e juaj, të asamblesë. "Mua kur të më vjen vendimi i AK nuk më shkruan se ka votuar PDK-ja apo LDK-ja. Mua më vinë projektet që ka miratuar asambleja dhe më duhet implementuar. Tash sa është fuqia e votës është tjetër. Kjo duhet t'ju nxit për të punuar në terren juve më shumë. Unë punoj sipas agjendës që ma jepni ju. Deri me sot kështu ka ndodhur. Po, kam shtruar edhe rrugë që keni pasur thënë që kryetari nuk e shtron atë rrugë që s'ka vota fare, rruga "Osman Krasniqi" apo një tjetër. Thoshit s'ka vota, megjithatë ju shtrova edhe sepse i kishit votat ju. Domethënë, që nuk ishte problemi te votat për arsye se nuk di në cilin mjedis PDK është që s'ka vota. Participimi e dini që është një kod që kemi lënë. Participimi është në dy segmente: në një me donatorë të ndryshëm që vinë nga faktorë të jashtëm dhe me ata qytetarë, të cilët si rezultat i presionit që kanë dhe donë thjeshtë dhe për ta shtyrë "dhunshëm", për ta shtyrë një projekt. Ju e dini fort mirë këtu e kam thënë, ata që janë të gatshëm të japin mbi 20-25 për qind deri 30 për qind, ata e marrin projektin, edhe nuk mund t'i lë pa i mbështetur. Kam për të gjetur forma qysh për t'i realizuar ato projekte. Aty ku ka një vullnet të qytetarëve edhe atij vullneti nuk mund t'i shmangemi. Por, gjithmonë duke marrë parasysh që këto që janë koduar këtu për t'i realizuar si ekzekutiv. Planifikimet që i ka bërë Abazi të jeni shumë të sigurt, se ju e keni lexuar materialin, unë nuk e kam lexuar, sepse këtij i besoj shumë", ka shtuar kryetari Bashota.

**Abaz Foniqi**, sqaroi rreth interesimeve të anëtarëve. "Ligjet që i ka lexuar nuk e abstrehoj se cilat janë ato ligje, por, nëse Skënderi thotë se nuk janë në harmoni projektet e miratuara në AK me projektet që i kam qitur unë në planifikim nuk qëndron, se në planifikim të buxhetit janë disa projekte që veç kontrata është për to trevjeçare, është vazhdimësi. Unë nuk kam mundur për t'i qitur se është planifikim i prokurimit, jo planifikim i shpenzimeve etj. Cilin prokurim kam për ta bërë më 2017? Andaj ato projekte që janë në buxhet dhe ato vlera që janë në buxhet, nuk do të thotë se duhet kthyer edhe një herë për të bërë procedurë të prokurimit. Kjo nuk të përputhet ty. Ndërsa, sa i përket prokurorisë që thatë, unë e di për faleminderit që ma përkujton, por unë po them ata janë ardhur për të kontrolluar, me marrë dokumente dhe për të vërtetuar fjalët që janë folur nëpër oda, nëpër çajtoje, nëpër kafe, a janë ashtu apo nuk janë ashtu. Unë i qëndroj asaj punës sime aty edhe prokuroria ka hetuar, edhe besoj që jemi korrekt", ka sqaruar zyrtari Foniqi.

**Filloreta Berisha**, tha se unë në këtë materialin medicinal sanitar jam pak konfuz, s'po mund ta kuptoj. "Pse Komuna e Klinës i ka bërë gjithë këto planifikime për 2017, ku shumica prej tyre, si produkte, artikuj, si të doni mund t'i emërtojmë, janë furnizime prej Ministrisë së Shëndetësisë, edhe po më duket e pakuptimtë, pse duhet QKMF-ja ose Drejtoria e Shëndetësisë kur bën planifikimin për vit e llogarit materialin, edhe pse furnizohet prej ministrisë. Pse Komuna të shpenzojë për këto, prandaj nuk po më duket disi e kuptimtë. Një, çka më bëri shumë përshtypje, lidhëse për martjen e gjakut i keni shkruar 150 copë 0.01 cent, s'ka. Neve na nevojiten 15 ose 20 për krejt vitin, por nuk kushton 0.01 cent, s'ka askund, nuk mund ta gjeni askund ashtu. Ose ka edhe plot gjera, por s'po i hymë me emra për secilën. Po më duket e pakuptimtë për të blerë Komuna diklofena etj., kur ne i marrim nga MSH, pse të blihen, më mirë këto mjete për t'i çuar diku tjetër", theksoi Dr. Berisha.

**Haxhi Ibishi**, tha se me vetë faktin që jam marrë me problemet e shëndetësisë, ky është planifikim, ky është planifikim i ZP, i cili në momente të caktuara prej njësive që kanë nevojë brenda krejt sistemit organizativ të komunës sonë, mund për të mos pasur pengesë në blerje e atij materiali, unë kështu e kuptoj, e para. Jo detyrimisht blihen, por që i jepet hapësirë për blerje, e njoh problematikën e shëndetësisë, nuk mund të mbyllet me listën esenciale nevojat e Klinës, mbetet hapësira për të ndërhyrë dhe gjithmonë ekzekutivi ka ndërhyrë në bokse që në shëndetësi janë quajtur bokse emergjente, të cilat në çdo muaj janë mbi 600 euro, të cilat në fund të

vitit kalojnë mbi 8000-9000 euro që duhet material siguruar shtesë. Mendoj që këto kërkesa janë profesionale që kanë ardhur, nuk do të thotë që zbatohet prokurimi ashtu qysh është i planifikuar, megjithatë unë mendoj që është një prokurim i balancuar i kërkesave në shërbim të qytetarëve, të cilat mbuluar në drejtoritë gjegjëse. Ndërsa, për atë për projektet kapitale askush nuk mund ta bëjë asnjë ndryshim, qysh e tha edhe zoti Gashi në vendimet dhe projektet kapitale që merr kjo asamble. Do të thotë kur të miratohet buxheti është alfa dhe omega e veprimit të ekzekutivit. Mendoj që janë shterë diskutimet rreth kësaj çështjeje, prandaj ky është vetëm një planifikim i prokurimit, ju kisha lutur të deklarohuni me votën tuaj”, theksi Kryesuesi Ibishi.

Kryesuesi vuri në miratimi Planin e Prokurimit për vitin 2017.

**Me 15 vota për, 11 kundër u miratua Plani i Prokurimi për 2017.**

**Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-rregullore komunale për menaxhimin e Mbeturinave,**

**Haxhi Ibishi**, tha se janë tri tema për të cilat kjo draft-rregullore ka kaluar nëpër disa faza, kemi kaluar në asamblenë e kaluar për diskutim publik, është mbajtur diskutimi publik për këto tri çështje, e kemi diskutuar në KPF edhe kemi ardhur deri këtu. Ndoshta ju kisha lutur që për hir të efikasitetit secili GP për t’u deklaruar, edhe pse është e padrejtë të mohohet të tjerëve për pikën gjegjëse, mirëpo si praktikë profesionale, në KPF kemi thënë që GP të shqyrtojnë materialin dhe të japin vërejtjet e tyre. Andaj, ju kisha ftuar shefat e grupet parlamentare të bëjnë nga një deklaram, ndoshta, mendoj që është mirë si grup për t’u deklaruar. Megjithatë secili ka të drejtë për ta shprehur mendimin e vet,” ka shtuar Dr. Ibishi.

**Halil Desku (PDK)**, tha se kemi kaluar të gjitha procedurat të këtyre pikave të rendit të ditës që u potencuan rreth ambientit, madje edhe një seancë të jashtëzakonshme e kemi mbajtur. “Unë mendoj që janë shterur diskutimet rreth tyre dhe jam pro miratimit të tyre qysh janë veç e veç të parapara në rend të ditës”, shtoi prof. Desku.

**Arben Limani (LDK)**, tha se edhe ne si grup i asamblistëve e mbështesim miratimin e kësaj rregulloreje.

**Vlora Tafili (AAK)**, tha se si AAK jemi për ta mbështetur këtë rregullore, por desha t’i them disa vërejtje nëse më lejohet. “Sa e kam parë rregullore, duke filluar prej përgjegjësitë e Komunës mbi menaxhimin e mbeturinave, e keni dhënë një nen shumë të shkurtër, por që ka një domethënie shumë të gjatë edhe që ka një rol goxha të rëndësishëm për menaxhimin dhe performancës së grumbullimit të mbeturinave. Jap si propozim që, Njësia themelore për menaxhimin e mbeturinave të kalon në një nen të veçantë, edhe të themelohet komisioni këshillues. Ky komision këshillues do të formohet prej anëtarëve, të cilët janë anëtarë që hynë në kuadër të këtij këshilli, cilat janë detyrat e komisionit, plus të mos harrojmë se këta anëtarë duhet të kompensohen me mëditje sipas Ligjit për menaxhim të financave lokale. E dyta, desha të ndërlihem te një vërejtje te dispozita ndëshkuese apo gjobat (lexoi nenin). Unë mendoj që kamata ligjore është mirë të hiqet. Se derisa atij po i grumbullohen veç qytetari po dënohet më shumë, me borxhe, me borxhi dhe qytetari po kalon tamam me krejt borxhe. Edhe tjetra, e kam parë një rregullore që m’u duk shumë e mirë për t’u ndihmuar qytetarëve: “Obligohen t’i paguajnë faturat me taksë të mbeturinave apo pagesën mund ta bëjnë me këste”. Pse Komuna e Klinë të mos ta ketë edhe këtë shembull në rregullore e saj”, ka theksuar anëtarja Tafili.

**Ndue Shabanaj (IPK)**, tha se ne po mendojmë se ne po trajtojmë një rregullore fillimisht që ka një rëndësi të madhe. “Edhe unë mendoj që si material kjo më të vërtetë është në nivel dhe marrë në përgjithësi çka rregullohet me të, domethënë i kontribuon një ruajtjeje dhe përmirësimit jetësor që është me rëndësi shumë të madhe për krejt qytetarët e Komunës tonë. Mirë është për të pasur dhe mirë është që po e kemi në shqyrtim dhe do të miratohet kjo Rregullore komunale për menaxhimin e mbeturinave. E bëjmë hapin e rëndësishëm drejt përmirësimit të mjedisit jetësor, por si parakusht është rregullimi ose menaxhimi i mbeturinave. Ndonëse menjëherë më këtë lidhet edhe nevoja për rrjetin e kanalizimit, që gjithashtu është shumë me rëndësi edhe është një prej kriterëve më të rëndësishme për t’i kontribuar një ambienti të pastër dhe të shëndoshë. Unë mendoj që shumë çka është thënë dhe precizuar në këto nene të veçanta të projekt-rregullore qëndrojnë, qëndron edhe kjo

çështja e gjobitjes së qytetarëve në raste të mospërfilljes dhe moszbatimit të obligimeve të tyre, por, natyrisht se angazhimi duhet të jetë në realizimin e obligimeve e jo në lënien për një kohë të gjatë pa i kërkuar këto. Dhe atëherë thjeshtë një neglizhencë e këtillë e mospagesës me kohë dhe mos angazhimit të subjektit për t'i tubuar obligimet ose detyrimet nga qytetarët e shtyn deri te marrja e vendimit për gjobitje. Unë mendoj që këtu duhet për të qenë më ekspeditiv në kuptimin e grumbullimit të detyrimeve që i kanë qytetarët, e më pak të lënies në stih dhe të merremi me gjobat. Kështu, përndryshe edhe këto shumat e gjobitjes për mendimin tim janë në nivel”, ka theksuar prof. Shabanaj.

**Skënder Merturi, (Grupi 3 Plus)**, tha se në leximin e parë e kam përmendur që është një rregullore e mirë, edhe po dua ta përsëris prapë që është një rregullore e mirë. “Po e kam një pyetje për drejtorin: a është menduar që Klina ta krijojë një kompani për menaxhimin e mbeturinave se jemi në kuadër të një kompanie rajonale që është më shumë e varur prej Pejës. A është menduar ta ketë në të ardhmen një kompani për menaxhimin e mbeturinave, e para, edhe e dyta, një sqarim të na jepet, sa ka mundësi Komuna e Klinës me t'u krijuar kushtet qytetarëve për klasifikimin e mbeturinave, të letrës, të plastikës, dhe ato gjerat tjera. Përndryshe, rregullorja në tërësi është e mirë, por sa do të gjejë zbatim kjo rregullore, është një çështje tjetër”, ka pohuar anëtari Merturi.

**Vlora Tafili**, tha se te neni 5: “Përgjegjësitë e Komunës mbi menaxhimin e mbeturinave. Neni 5.8 thotë: “Sipas nevojës autorizon operatorin. “ Autorizon” është vetëm për t'i dhënë të drejtën. Unë mendoj që në vend “autorizon” të thotë që “obligon” operatorin”. Po ashtu ne si Komunën e Klinës problemin më të madhe e kemi me deponinë ilegale. Mirëpo identifikimi i pikave të deponive ilegale, edhe eliminimi i tyre, unë mendoj që është dashur për t'u zgjatur pak më shumë kjo pikë, sepse deri tash në Komunën e Klinës ka ndodhur që deponitë për t'i zhvendosur, prej një hapësire në një hapësirë tjetër. Le të precizohet pak më shumë se si do të eliminohen këto deponi”, ka theksuar anëtarja Tafili.

**Fadil Gashi**, tha se në KPF e kam thënë qysh po e them tash. “Po na thoni hajt ta aprovojmë në KPF, se ka për të dalë në seancë, edhe bisedojmë në seancë. Kur po vjen në seancë po thonë jo në seancë nuk po flasim se ne vetëm po e lëshojmë në diskutim publik, se prapë ka për t'u kthyer, edhe na u ka kthyer. Tani prapë në KPF ne thamë bashkë hajt po e lëshojmë për seancë. Edhe sot po thua, veç prononcohuni edhe hajt ta votojmë, edhe ne po e lëmë këtë punë. Ju Kryesues e filluat kështu, tash u lëshuat në debat. Edhe tash po na hyni në hak se shefi ynë e tha, ne po e mbështesim, por tash dikush po flet e dikush s'po flet. Edhe nëse duhet për të folur, unë po ju propozoj një diçka: në momentin që miratohet kjo rregullore, unë po ju lus, hiqeni urdhëresën që ju qytetarët i obligoni me regjistrim të veturave. Është urdhëresë e kundërligjshme. Tash është kompania, i ka masat ligjore, i ka instrumentet ligjorë dhe ju mos e shkelni ligjin. Mos bini në shkelje të ligjit, jemi dakord”, tha anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, tha se pa dashur për t'u arsyetuar në atë, unë mendoj që secili ka të drejtë për të diskutuar. “Prandaj nuk e kemi tendencë për të kufizuar debatin, por e kemi parë që kjo draft-rregullore është kështu e hartuar për të gjitha komunat në RK, prandaj në të ardhmen Fadili edhe në KPF e ka propozuar çështjen e urdhëresës për detyrimin e qytetarëve, ajo është diçka tjetër. Me vetë deklarinimin e kryetarëve të GP mendoj që është shterur tema e debatit me vërejtjet që i ka prezantuar Vlora me arsye nga ai këndvështrimi i saj”, tha Kryesuesi.

**Gjokë Lleshaj**, tha se ndoshta Vlora prej rregullores doli te plani ose prej planit te rregullorja. “Shiko, ndoshta i ke të qarta dhe kur dhe si me plane. “Domethënë i ke përzier veç rregulloren me plan. Këtu ke pasur pak shpërputhje, ke dalë prej rregullores, qe ku e ke planin kur dhe si kanë për t'u zbatuar. Sepse gjithë ato që i the nuk qenë për rregullore, nuk ekzistojnë ato në rregullore, ato i ke në plan. Këqyre planin dhe rregulloren, këtu t'u kanë përzier pak”.

**Dardan Bashota**, Zyrtar për Mjedis, foli rreth çështjes në shqyrtim. Zyrtari Bashota theksoi se qëllimi i kësaj rregulloreje është menaxhimi i integruar i mbeturinave në tërë territorin e Komunës së Klinës. “Tek çështja e taksave dhe e gjobave mandatore, kjo taksë është caktuar në bazë të Zyrës Rregullatore për Mbeturina dhe duke i marrë për bazë shpenzimet operationale të KRM “Ambienti”. Tek pjesa e gjobave, kjo rregullore nuk e ka

rëndësinë e vet nëse nuk e përmban edhe pjesën e gjobave. Jam ithtar i futjes së kësaj kompanie për menaxhim të mbeturinave nën ombrellën e Komunës pasi që Komuna do të ketë të hyra më të mëdha dhe do të menaxhojë më mirë këtë sektor të mbeturinave. Si shembull, kemi Komunën e Prizrenit, e cila e ka nën menaxhim komunal këtë sektor”, ka shtuar ndër të tjera zyrtari Bashota.

Kryesuesi vuri në miratim Draft-rregullores komunale për menaxhimin e Mbeturinave.

**Me vota unanime (25), pa kundër dhe pa abstenim u miratua Draft-rregullorja për menaxhimin e mbeturinave.**

**Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2017-2021.**

Kryesuesi hapi debatin. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim.

**Me vota unanime (25) u miratua Draft-plani komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2017-2021.**

**Pika e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit komunal të integritetit 2017-2019,**

Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim.

**Me vota unanime (26) u miratua Draft-plani për Integritet 2017-2019.**

**Pika e tetë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për iniciimin e procedurës për vënie në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe taksa komunale (dhjetor 2014).**

Kryesuesi foli rreth çështjes në shqyrtim. Hapi diskutimin. Nuk pati diskutime. Kryesuesi vuri në miratim.

**Me vota unanime (26) u miratua Propozimit për iniciimin e procedurës për vënie në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe taksa komunale (dhjetor 2014).**

**Pika e nëntë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për iniciimin e procedurës për hartimin e Hartave Zonale për Komunën e Klinës.**

Kryesuesi foli rreth çështjes në shqyrtim. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim propozim-vendimin.

**Me vota unanime (26) u miratua propozim-vendimi për iniciimin e procedurës për hartimin e Hartave Zonale për Komunën e Klinës.**

Kryesuesi ftoi shefat e GP në ora 12.30 në zyrën time e përpilojnë Deklaratën e përbashkët për rastin e Ramush Haradinjat.

Kryesuesi kërkoi pushim prej orës 12-13.

Pas një ore të pauzës Kryesuesi procedoi me vazhdimin e pjesë së dytë të seancës.

**Pika e dhjetë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit nga DKRS për subvencionimin e katër klubet sportive të Komunës së Klinës.**

Kryesuesi foli rreth çështjes në shqyrtim.

**Haxhi Ibishi**, tha se ju e dini që sporti në Komunën e Klinës është një prej aktiviteteve që Komuna e Klinës është duke i sponsoruar bukur shumë në vitet e fundit. “Janë kërkesat të cilat kanë kaluar nëpër KPF. Sot e keni një propozim saktësisht në shpërndarje që e ka menduar ekzekutivi për ndihmë klubeve. Unë nuk kisha dashur

më shumë për ta ngarkuar këtë pikë të rendit të ditës, por e bart fjalën të drejtoresha ose te ekzekutivi që ta arsyetojnë këtë propozim. Pastaj shefat e GP edhe delegatët janë ata që vendosin”, tha Kryesuesi, i cili në vijim fjalën e barte te znj. Kristina Lazri, drejtoreshë e DKRS.

**Kristina Lazri (drejtoreshë e DKRS)**, tha se ne e kemi diskutuar në KPF mënyrën e subvencionimit të klubeve sportive në Komunën e Klinës. “Realisht ju i keni marrë me kohë edhe projekt-propozimet nga të gjitha klubet. DKRS ka 51 mijë euro subvencione, ndërsa pjesa tjetër është nga Zyra e Kryetarit. Si ekzekutiv mjetet e propozuara për ndarje janë kështu: KF “Dukagjini” – 35 mijë; KF “Dukagjini” (F) – 4 mijë; KV (F) -3 mijë dhe KH (M) – 2 mijë”, theksoi drejtoresha Lazri.

**Vlora Tafili**, tha se desha të lidhem tek propozimi për subvencionimin e Klubit të volejbollit. “Unë mendoj që nuk është e mjaftueshme shuma prej 3 mijë euro. “Unë vetë jam në atë klub dhe po i shoh kërkesat për shpenzimet që i kemi ne. Kisha propozuar që me mirëkuptim të të gjithëve të na shtohen edhe 2 mijë euro dhe të bëhen gjithsej 5 mijë euro”, tha anëtarja Tafili.

**Violeta Zefi**, tha se në lidhje me propozimin e drejtoreshë së DKRS-së, edhe unë personalisht mendoj që duhet për t’u përkrahur këto kërkesa të klubeve të caktuara. “Nëse është e mundur që të rriten ato shifra pse jo, domethënë po që se ka mundësi buxhetore. Por më konkretisht kisha propozuar që nëse nuk është e mundur për t’u financuar këto shuma secila prej këtyre klubeve, atëherë, nëse është e mundur për të pasur pak, po them kushtimisht lëshim, që janë klube të femrave, përkatësisht vajzave, në mënyrë që normalisht të kenë pak më përparësi në raport me klubet tjera”, ka pohuar anëtarja Zefi.

**Tunë Dedaj**, tha se në emër të Grupit të AAK-së, kur flitet për sportin, t’ju themi të drejtën, unë angazhohem maksimalisht, por edhe grupi im që i takoj, që sa më shumë t’ju sigurohen mjete të rinjve, edhe klubeve sportive dhe më duket që kjo shumë, që edhe ndoshta nuk ekzistojnë mundësitë, është shumë tepër e vogël, duke marrë nurin e madh të klubeve. Ne të gjithë e dimë që shpenzimet më të mëdha i bën KF “Dukagjini”, për arsye se ka lojtarë sa trefishin e klubeve tjera, por është mirë për t’u angazhuar që në të ardhmen për t’ju siguruar mjete, e jo për t’ju ndarë 50 mijë euro për sporte, por AK për ta marrë një vendim që shuma më e vogël për sporte të Komunës së Klinës për të qenë ndarja prej 100 mijë euro”, ka shtuar anëtari Dedaj.

**Arben Limani**, tha se unë e pashë propozimin që ka bërë drejtoresha për subvencionim të klubeve. “Ajo çka më bëri përshtypje tek klubi i fundit i hendbollit, është një klub i ri, klub që unë vetë kam parë disa ndeshje të këtij klubi dhe ishte për lakmi më punën që po e bëjshin ata djem të rinj, edhe trajnerët. Unë kisha kërkuar që këtij klubi t’i dyfishohet shuma nëse ka mundësi buxhetore, klubit të hendbollit “Dukagjini. Nëse janë mundësitë buxhetore këtij klubi t’i ndihmohet se edhe kanë ndeshje më shumë, drejtoresha duhet ta di. Një ligë ku ka ekipe më shumë ata në sezona zhvillojnë ndeshje më shumë, kuptohet që edhe shpenzimet janë shumë më të mëdha. Andaj kjo shumë nuk iu del atyre as për shpenzime të udhëtimit e të ushqimit”, theksoi anëtari Limani.

**Skënder Merturi**, tha se besoj që të gjithë jemi të pajtimit për të përkrahur sportin në tërësi, edhe këto klubet që na kanë ardhur, por një pyetje e kam: “Nëse krijohet një klub i ri a do të kemi mjete për ta përkrahur, kur po dimë që këto mjete çka i kemi ne po i shpërndajmë për këto klube që na kanë ardhur këtu me propozime, e para. E dyta, nëse do të ketë mundësi KF “Dukagjini”, t’i hiqen 5 mijë euro dhe t’u shpërndahen këtyre klubeve tjera dhe klubi i Dukagjinit i lihen 30 mijë euro, e dimë ndoshta është pak, por e dimë që klubi “Dukagjini” i meshkujve është klubi më i hershëm. Edhe ndoshta për të siguruar mjete ose donacion, ose përkrahje, jashtë KK, e ka pak më lehtë në krahasim me këto klubet tjera. Domethënë t’ia zvogëlojmë këtë 35 mijë, po ia lëmë 30 mijë “Dukagjinit” të meshkujve, 5 mijë t’ju shpërndajmë këtyre klubeve tjera, domethënë që këto klube që janë krijuar tashti t’u japim një përkrahje pak më të madhe. Ky është mendimi im që mendoj do të kishte qenë pak më mirë, duke e ditur që “Dukagjini” i meshkujve siguron mjete ose përkrahet pak më shumë edhe prej donatorëve tjera. Vetëm të mos më merret keq te lojtarët që mund të më interpretohet që Skenda ka kërkuar për

t'iu zvogëluar paratë. Mos të interpretohet kjo çka e thashë për të keq te lojtarët. Sido që të vendoset unë jam për ta përkrahur edhe do ta përkrah”, tha anëtari Merturi.

**Rasim Millakut**, tha se ne morëm katër propozime konkrete për katër klube sportive të Klinës, këtu shihet atmosfera që të gjithë jemi në dakord për ta përkrahur sportin, e sidomos sportin vendor ku aty bëjnë pjesë kryesisht rini dhe pjesa më e madhe edhe nxënës të shkollave tona. “Një asamble më herët kemi trajtuar disa probleme, mirëpo një prej problemeve më të mëdha që ka qenë, kyçja e të rinjve, gjegjësisht dyshimi i të rinjve nëpër veprime që i dëmtojnë rininë. Gjithsesi duhet t’i mbështesim rininë për sport, por unë kam një propozim konkret: t’i mbështesim, por edhe t’i kontrollojmë për sukseset që i kanë, sepse ne asnjë prej xhepit nuk i japim, por prej taksapaguesve të qytetarëve tanë, edhe duhet t’i arsyetojnë se secili klub çka bëri për një kohë të caktuar. Mbi njohurinë që unë kam, e ndaj mendimin me Arbenin që një klub i ri i hendbollit të meshkujve kisha të them që ngjitet pas KF “Dukagjinit” të meshkujve me sukseset dhe angazhimet që ka në punë dhe le të mbështetet sipas sukseseve që i ka, duke mos i anashkaluar edhe klubet tjera, por, nëse nuk ka suksese, nëse nuk ka punë në klube të mos gjuajmë kot mjete, por t’i mobilizojmë ose t’i mbështesim klubet që kanë edhe punë serioze. Unë e mbështes klubin, gjegjësisht e mbështes punën që e kam parë edhe vetë te klubi i hendbollit të meshkujve që ishte një klub kryesisht me të rinj dhe me ambicie që ndoshta me përkrahjen tonë, ose me vazhdim të përkrahjes që ju kemi bërë klubeve tjera sonë, do të kishte emblemetuar Klinën gjithnjë dhe shumë më shpejt se sa klubet tjera që po i përkrahim”, tha anëtari Millaku.

**Ramush Agushi**, tha se unë i falënderoj të gjithë që po e përkrahin këtë iniciativë dhe më së pari falënderoj edhe drejtoreshën për propozim-vendimin qysh e kemi kërkuar ne në KPF për të na prurë njëfarë vendimi sa edhe qysh. “Unë i dëgjova për raport që thanë për shpërndarjen, edhe unë jam për të njëjtën gjë, për t’i shpërndarë përafërsisht këto 5 mijë euro, mirëpo kisha shkuar në mënyrë konkrete: te “Dukagjini”, klubi i femrave kisha kërkuar për të rritë shumën, te hendbolli po ashtu kisha kërkuar për ta rritur pak, edhe kështu të bëhet shpërndarja e këtyre 5 mijë eurove. Nuk është që i plotësojnë kushtet, por duhet për të menduar për të gjetur mënyrën për t’i plotësuar, pavarësisht tashti, që i dimë ne kushtet dhe sa kemi shpenzime aty. Unë kisha kërkuar për të gjetur një mirëkuptim dhe për ta bërë këtë shpërndarje. Propozoj konkretisht: 2 mijë euro kisha propozuar për t’i çuar te femrat, klubi i femrave të futbollit, 1 mijë euro për klubin e volejbollit, femrave, edhe te hendbolli kisha kërkuar 2 mijë”, ka theksuar anëtari Agushi.

**Ndue Shabanaj**, tha se unë mendoj se gati mendimi im po përputhet edhe me këto propozimet që i dha Ramushi. “Por, realisht është mirë që me mundësitë buxhetore që i ka Komuna e Klinës po e përkrah sportin, kur dihet që mundësitë e rinisë tonë dhe format tjera të angazhimit dhe veprimtarisë së tyre rinore janë shumë të kufizuara. Prandaj sikur edhe në sport të mos përkrahët në një formë tubimi i tyre dhe mundësia për të pasur një angazhim rinor, atëherë me të vërtetë do të kishte qenë shumë keq. Mundësitë buxhetore që janë ne po i shohin, edhe është mirë për t’u ndarë në mënyrë sa më proporcionale, edhe në mënyrën sa më meritore të mundshme. Edhe unë jam i mendimit që klubin e hendbollit “Dukagjini” të mos lihet në këtë shumë, por së paku për ta barazuar me klubin e femrave të volejbollit, për të mos lënë këtë me një dallim kaq të madh për shkak se edhe thuhet, edhe ka shënime dhe të dhëna se janë të suksesshëm dhe në gjitha garat janë shumë premtues. Prandaj, ka nevojë për ta stimuluar dhe ka nevojë për ta përkrahur. Këtë propozimin që dha Ramushi për t’i ndarë ato 5 mijë euro, unë mendoj që ka mundësi, tri këto klubet tjera përfaqësuese të ngritët niveli i përkrahjes financiare edhe të mundësohet që secili klub ta ketë veprimtarinë e vet më të mirë”, ka konstatuar prof. Shabanaj.

**Vlora Tafili**, tha se tash folëm për futbollin e meshkujve, po ashtu edhe hendbollin e meshkujve, dua të flas edhe një herë për ta mbrojtur fuqishëm klubin tonë të volejbollit të femrave. “Ky profesori veç e tha se duhet të investohet tek rinia edhe aty ku duhet për të avancuar. Por, unë jam e vetmja në klub që kam 24 vjet, aty janë lojtarët prej moshës 16 -18 vjet. Më e arsyeshme se për të investuar në klub të volejbollit nuk e shoh të arsyeshme askund. Më pëlqej ideja për t’i shpërndarë mjetet për arsye se tashmë futbollit i meshkujve që është ikonë e qytetit, mund të ketë edhe donatorë nga jashtë, ndërsa ne si klub e kemi problem në tërheqjen e donatorëve nga jashtë, edhe për këtë në përkrahje e kemi të vetmen Komunën e Klinës”, theksoi anëtarja Tafili.

**Qamile Qitaku**, tha se meqenëse është fjala për subvencione, dihet se ka ardhur si kërkesë e klubeve, që nuk kam asgjë kundër tyre, përkatësisht të kësaj shpërndarjeje. “Por, unë kam një kërkesë për Drejtorinë e Kulturës për Rini e Sport, që në kuadër të organizimit të drejtorisë, sigurisht edhe nëpërmes subvencioneve, të krijohen edhe të organizohen edhe aktivitetet tjera për fëmijë, sidomos për të rinjtë, qoftë ato kulturore apo sportive, kështu që fëmija ynë të orientohet pak se nuk ka asnjë aktivitet për fëmijët. Nuk do të thotë që të gjithë janë të interesuar vetëm për sport, por qoftë aktivitete muzikore, kulturore apo çka do qoftë tjetër të organizohen në kuadër të Drejtorisë për Kulturës”, u shpreh anëtarja Qitaku.

**Filloreta Berisha**, tha se edhe unë në emër të grupit të LDK-së, tash po flas për krejt. “Për të ma parë kështu edhe syri më mirë, këtyre tri klubeve, 2, 3 dhe 4, për t’iu bërë rrafsh nga 5 mijë euro, 1 mijë le t’i qet kryetari, këto 5 mijë le t’i ndajmë në mënyrë prepozicionale për këta, edhe 30 mijë le t’i mbesin “Dukagjini” klubit të meshkujve. Mendoj që edhe për sy duket hijshëm për ta parë kështu më mirë. Për 1 mijë euro kryetarin po e shtymë pak ngushtë, por nuk ngushtohet për këtë shumë”, tha Dr. Berisha.

**Haxhi Ibishi**, tha se vetëm një gjë nuk dëshiroj për t’i hyrë në hak KF të femrave. “Pa dashur për të bërë ndonjë replikë, por rezultatet e tyre ato janë inkurajuese shumë, aty janë 22 vasha që luajnë, që janë ekuivalent që luajnë futbollin mirë. Moshë U16 ka arritur rezultate të jashtëzakonshme në nivel republike, që janë të ftuara 5 vajza tona për të mbrojtur ngjyrat e reprezentacionit të Kosovës. Prandaj, unë mendoj që prioritet mbi prioritet Klina ka vendosur KF “Dukagjini”, duke e parë njeriun që ka qenë shumë i marrë në këto 20 vite me klubin “Dukagjini”, që heqin dorë në atë skemën e propozuar, unë mendoj që kryetari nuk do të jetë dorështregues në këtë skemën, vetë ka vendosur prioritetet e futbollit. Kryetari është dashamir i sportit ka dëshmuar dhe mendoj që e ka përgjegjësinë për të na propozuar”, tha Kryesuesi.

**Ramush Agushi**, tha se unë nuk kam kundër asnjë klubi, mirëpo për ta barazuar klubin e volejbollit të femrave dhe klubin e hendbollit të femrave me klubin e futbollit të femrave është pak shumë rëndë se lëre që i ka 22 në grupin e futbollit 22 femra që i ka klubi, por plus e ka U 16 që është e obliguar për ta pasur, aty bëjnë mbi 35 të sigurta. “Edhe tash kur të llogarisësh 35 vetë me maksimumin 15-16 vetë, edhe duke e ditur orarin e tyre dhe sa ndeshje i zhvillojnë ata me këta, nuk mund të shkojmë në atë mënyrë, jo për që nuk kam dëshirë, se nuk kam asgjë kundër asnjë klubi, kam dëshirë për secilin klub me emrin e “Dukagjini”, kam dëshirë për ta parë në piedestal më të lartin, por duhet për ta ditur që klubi i femrave i futbollit sa klube garojnë në atë ligë dhe sa garojnë në klubin e futbollit të femrave, tash duhet për të ndarë atë, edhe klubin e hendbollit “Dukagjini”, duhet për ta ditur sa klube dhe sa ndeshje gjatë një sezoni kanë ata dhe sa këta. Duke i llogaritur këto vjen kjo shumë se nuk e thashë më asfajë tendence apo kurrfarë qëllimi, mirëpo pranova klubin “Dukagjini për t’iu hequr dhe për të kaluar kënde, vetëm për t’i përkrahur këta më shumë edhe tjerat klube. Prandaj mendoj që kjo është mënyra më e mirë e mundshme që do të kishte pasur mundësi të ekzistojë”, konstatoi anëtari Agushi.

**Tunë Dedaj**, tha se kam një propozim që nga ekzekutivi çdo drejtor të jep nga 100 euro të jap për sportin, edhe na që jemi anëtar të KK të japim nga 50 euro.

**Kristina Lazri**, tha se unë dua t’u përgjigjem disa pyetjeve që u shtruan. “Një pyetje ishte çka nëse licencohet edhe ndonjë klub tjetër, për 2017 ka marrë fund gjithçka, sepse sezoni vetëm ka filluar, nëse do të ketë kërkesa për 2018, është buxheti i ri. Thjesht unë jam e thirrur këtu për të mbrojtur çdo klub. Këto katër klube që i kemi të licencuara të gjitha jam për t’i mbrojtur. Ishte një pyetje që në bazë të suksesit, nuk mund ta kesh një sukses aq të madh për një vit, është një vit që janë formuar këto klube, ne kemi suksese shumë të mëdha në krahasim me kohën. Është shumë e vërtetë që KF të vajzave ka arritur suksese shumë të mëdha, edhe do të arrihet me përkrahje, nuk janë 44 lojtare janë 22, sepse është ajo moshë që luajnë edhe për U16, pra për të njëjtin klub, mirëpo unë jam për të pasur përparësi. Te volejbollit është një problem që i kanë me pagesë, koetizimin, referat etj., për këtë kemi kërkuar ndoshta më shumë, 1 mijë euro, se sa këto tjera. Hendbolli është për lakmi, edhe është një moshë 14 vjeçare deri në 17 vjeç, edhe nëse përkrahet, edhe nga donatorët, këtë vit do të hyjnë edhe në superligë, nëse përkrahet. Kështu që u dhanë disa propozime, disa ide, edhe Ramushi e dha një ide shumë të mirë, prandaj vendosni qysh ju ta shihni në mënyrën sa më racionale”, theksoi drejtoresha Lazri.



**Sokol Bashota**, tha se po e them në thonjëza, sepse keqkuptohet dhe krijohet përshtypja që po bëjmë pazare. “Atë 5 mijë, 2 mijë lëreni për nevojat e festave të ndryshme që janë në Klinë, për të pasur drejtoria për t’i mbuluar, edhe 3 mijë ndani për klube. Subvencionet janë më të vogla. Të jeni shumë të sigurt unë ato i kam lënë thjeshtë për të mos lënë diçka keq, por i kemi bërë si shpërndarje, edhe me idenë që këtë 5 mijë euro, nëse veç gjendet kompromisi i të gjithëve, gati-gati për t’i hequr tërësisht për të menduar për nevoja në fillim të vitit, edhe subvencionet komplet gati i kam kaluar nëpër sektorët përkatës të mos merrem unë me to për shkak se tash mbi 2 mijë euro vendos asambleja, edhe për ndonjë klube, edhe për diçka, deri 1 mijë euro 1500 mund për t’i plotësuar, por do të ishte mirë për t’i ndarë këto. Për lakmi janë të gjitha klubet, edhe këto të rejat që janë formuar tash, domethënë për një kohë kaq të shkurtër të hynë në top listën e sukseseve në nivel të Kosovës nuk është pak, edhe gati-gati pa përkrahje kanë arritur këto suksese, prandaj për t’ju shtuar këto 1000 mendoj që plotësohen mirë. Pastaj ju e dini që për disa nevoja të tjera ne nuk i lëmë pa i mbështetur, sepse janë ushqimet, transportet, prapë Komuna duhet për të gjetur format për t’i mbuluar, edhe pse neve pastaj na adresohen si shpenzimet komunale, mirëpo ne gjithmonë i kemi mbështetur, me ushqim ose me transport për naftë, ku na është adresuar shpenzime për vetura. Këto janë bërë, sepse nuk ka kod tjetër. Uroj që, për t’ia kthyer dinjitetin Klinës, uroj që KF “Dukagjini” të hyjë në superligë, ku kishte për ta arsyetuar thjeshtë të gjitha këto shpenzime. Të gjitha premisat janë , nuk kanë qëndruar duarkryq, kanë plotësuar edhe disa ambicie, si blerje të lojtarëve me emër. Unë mendoj që tash nuk jemi keq , njëjtë kanë bërë gati edhe klubet tjera që janë pretendentë, qoftë të mos bien nga liga, qoftë të ngritën në tabelën e klasifikimit. Kanë bërë përgatitje të mëdha, ju e dini, se e përcillni komplet sportin. Prapë po e them edhe një: ndani këto në mënyrën më të mundshme si të dëshironi. Nëse veç iu lejon mundësia me qëllim për të mbijetuar për t’ju ndarë këtyre tre klubeve nga 1 mijë euro do të kishte qenë e më mirë, të tjerat për t’i lënë për aktivitete të tjera të ndryshme”, ka konstatuar kryetari Bashota.

**Rasim Millaku**, tha se po që se kuptohem drejt, thjesht vullnetin po e kemi të gjithë te shumat, edhe i kisha arsyetuar. “Si Kryetar i Komunës, lëroni tri klubeve të vogla nga 5 mijë qysh u tha, ose së paku nga 4 mijë mos i dalloni, edhe me “Dukagjinin”, nuk po dëshiroj për të diskutuar atë punë. Tria leri nga 4 mijë, se disa po thonë se kanë suksese më shumë, jem më të vonshëm, atëherë edhe klubi i hendbollit i meshkujve veç sa është regjistruar shumë më mirë është me rezultate”, shtoi anëtar i Millaku.

**Haxhi Ibishi**, tha që ta konkretizojmë: “KF Dukagjini 30 mijë; KF futbollit i femrave 50 mijë, prej 4 mijë – 5 mijë, klubi i volejbollit i femrave prej 3 mijë – 4 mijë, edhe klubi i hendbollit meshkujt, prej 2 mijë euro në 3 mijë. Kurse 2 mijë euro tjera mbesin për aktivitete sportive, kulturore, brenda vitit që organizon drejtoria”, ka theksuar kryesuesi Ibishi.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

**Me vota unanime (20) u miratua propozimi i Kryetarit për subvencionim të klubeve sportive.**

**Pika e njëmbëdhjetë: Nxjerrja e një deklarate mbështetëse për Ramush Haradinajn, i cili mbahet padrejtësisht në Francë.**

**Haxhi Ibishi**, tha se me propozimin e kryetarit dhe dakordimin e gjithë juve u formua një grup, faktikisht shefat e grupeve kuvendare, kanë hartuar një deklaratë politike të kësaj Kuvendi lidhur me arrestimin e kryetarit të AAK-së, z. Ramush Haradinaj, komandantit të UÇK-së për Dukagjin, i cili padrejtësisht po mbahet me një fletarrest të një shteti okupues të vitit 2004 po mbahet në Kolmar të Francës. “I bashkangjitemi edhe ne si Kuvend atyre shqetësimeve që janë ngritur në të gjitha kuvendet në nivel lokal dhe Kuvendit të RK”, theksoi kryesuesi Ibishi, i cili kërkoi që në emër të Kuvendit ta lexojë deklaratën.

Vlora Tafilaj, në emër të KK e lexoj Deklaratën. Deklarata ka këtë përmbajtje:

**DEKLARATË**

- 1. Ndalimi i ish- Komandantit të UÇK-së për Zonën Operative të Dukagjinit, ish- Kryeministrit të Kosovës dhe Kryetarit të AAK-së, z. Ramush Haradinaj, nga shteti i Francës, në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga shteti serb, është i padrejtë dhe krejtësisht politik.*
- 2. Z. Haradinaj e ka dëshmuar pafajësinë e tij në Gjykatën më të Lartë Ndërkombëtare, në Tribunalin e Hagës, i cili në dy shkallët e vendosjes e ka shpallur të pafajshëm nga të gjitha aktakuzat e pretenduara.*
- 3. Gjenocidin e ushtruar ndaj popullit të Kosovës, posaçërisht gjatë viteve të luftës 1998/99 e dënuan të gjitha shtetet demokratike të botës dhe e ndëshkuan me intervenimin e aleancës më të fuqishme të botës, NATO-s dhe shteti mik i Francës ishte pjesë e intervenimit për ndaljen e këtij gjenocidi. Franca ishte një ndër shtetet më aktive në procesin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe ndër të parët që ka njohur pavarësinë tonë.*
- 4. Ne besojmë fuqishëm se lufta e UÇK-së dhe e z. Ramush Haradinaj ishte luftë mbrojtëse, e drejtë dhe e pastër, pavarësisht tendencave të shtetit serb për të e kriminalizuar atë. Ne, po ashtu vlerësojmë kontributin e z. Haradinaj në çlirimin dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës.*
- 5. Kuvendi i Komunës së Klinës kërkon nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare që në asnjë rrethanë të mos lejojnë të nëpërkëmbën vlerat tona kombëtare, lufta e drejtë e UÇK-së dhe të insistojnë në ndalimin e gjahut të shtetit serb ndaj figurave emblematike të luftës dhe paqes, siç është edhe z. Ramush Haradinaj.*
- 6. Kërkojmë nga organet e drejtësisë Franceze që me procedura të përshpejtuara të shqyrtojnë rastin Haradinaj, njëkohësisht të ndërpriten keqpërdorimi që i bën Interpolit Qeveria e Serbisë, me ngritjen e aktakuzave të rrejshme politike dhe tendencioze ndaj ushtarëve të UÇK-së.*
- 7. Kërkojmë lirim sa më të shpejt dhe pa kushte të z. Ramush Haradinaj.*

*Klinë, më 24.2.2017*

*Kryesuesi i Kuvendit,  
Dr. Haxhi Ibishi*

**Sokol Bashota**, tha se me vullnet të madh e kam marrë këtë iniciativë, edhe pse në kuvendin e kaluar na ka kaluar i kur, të them shkurt, prej vëmendjes një ide e këtillë. “Për të dalë një deklaratë, të them se ekziston tash ky defekti profesional, si gjuhëtarë, do të ishte mire që kjo për t’iu nënshtruar një lekturë gjuhësore, se ka gabime gjuhësore, prandaj të rregullohen. Unë desha të ndalem te dy gjëra përmbajtjesore: desha të nisem nga fundi, kapitulli i 7 që është. Ta kemi të qartë, ne nuk kemi asgjë në këtë rast me QK, edhe një gjë të tillë po e bën edhe vetë Qeveria edhe institucionit, prej ministrit të Punëve të Brendshme, duke kërkuar nga Interpoli, që ka mbajtur disa takime rresht, për t’u hequr nga lista serbe emrat e ish-ushtarëve të UÇK-së. Kështu që do të ishte më fuqishëm pa këtë kapitullin e fundit, edhe është e përsëritur deri diku, në kapitullin e pestë. Kur ta lexoni do ta vëreni se është kapitull i përsëritur, kjo është nën një. Dhe nën dy, do të ndalëm këtu menjëherë të fjala e dytë këtu, te paragrafi i parë, ku thotë kështu: “ Ndalja e tejzgjatur”. Këtu është një gabim, kinse po i bien kinse sikur të ishte ndalur pak s’ka pasur dert. Këtu duhet hequr shprehjen “teyzgjatur”. Për neve sikur ta kishin ndaluar edhe për vetëm një minutë, edhe 100 minuta dhe 100 ditë, e 1000 ditë, është shumë. Kjo “teyzgjatur” të hiqet. Le të jetë: “Ndalja e ish-komandantit...” Këto dy segmente pata mundësi t’i vërej dhe në to të ndërhyhet”, ka theksuar kryetari Bashota.

**Fadil Gashi**, tha se absolutisht po pajtohem me kryetarin, faleminderit kryetar! “Veç desha ndoshta te e para, “ndalja e teyzgjatur”, a kishte qenë më mirë, bashkërisht ta debatojmë , të jetë “arrestimi dhe ndalja”.

Sepse, ai është arrestuar me një fletarrest të Serbisë. “Arrestimi dhe ndalja e Komandantit,” dhe tash të mos hyhet në kohëzgjatje. E tha edhe kryetari, në paragrafin e pestë, përsëritet tek e shtata, edhe ne nuk kemi asgjë kontestuese me institucionet tona. Shikoni, Parlamenti i Kosovës si organi më i lartë i shtetit veç ka nxjerrë rezolutë, e ka nxjerrë një rezolutë dhe ne duhet si Kuvend duhet për t’iu përshtatur atyre kornizave. Prandaj, edhe unë po pajtohem me kryetarin se kjo e 7-ta duhet të hiqet krejt, sepse veç përsëritet. Te e 6-ta, edhe këtu kisha kërkuar, po që se pajtohuni, për ta pasur një ndërhyrje të lehtë. Thotë: “Kërkojmë nga organet e drejtësisë Franceze që me procedura të përshpejtuara të shqyrtojnë rastin Haradinaj, njëkohësisht të ndërpritet keqpërdorimi që i bën Interpolit Qeveria e Serbisë, me ngritjen e aktakuzave të rrejshme politike dhe tendencioze ndaj ushtarëve të UÇK-së”. Shikoni, Franca nuk është duke e përdorur keqpërdorimin e Interpolit, Serbia është duke e keqpërdorur Interpolin. Ky është dokument zyrtar, edhe është i institucionit. Ne duhet thënë “Interpoli le të ndërpret arrestimet në bazë të kërkesave të Serbisë”, pa të drejtat e Serbisë. Por Franca nuk është duke e keqpërdorur as kjo. Vetëm ta formulojmë me kujdes, sepse ne më lart po thuhet se e kemi shtet mik Francën, edhe nuk e kemi atë telashe as me Francën, as me Shqipërinë. Ju e dini se ne kemi pasur raste edhe në kufi me Shqipërinë që na u kanë arrestuar me këso fletarrestesh. Prandaj, këtu me ia gjetur formën me kërkuar prej Interpolit, që të mos bien Interpoli viktimë, ose të mos e keqpërdor Interpolin Serbia. Se ajo është duke e keqpërdorur këtë Interpol. Edhe këtu nëse doni te e 5-ta të hiqet kjo “ndalimi i gjahut”, sepse ajo nuk mund të na gjuaje edhe po të trenohet Serbia nuk mund të na gjuajë neve, e kemi gjuajtur ne atë, edhe e kemi gjuajtur fort edhe keq. Po, kjo “e gjahut” është dokument, se ndryshme po të jepet ndonjë koment është çështje tjetër, mirëpo ky është një dokument i institucionit”, ka theksuar anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, tha se çdo angazhim edhe i kryetarit edhe i Fadilit, të kuptohemi drejt për të qenë sa më e fuqishme, sa më përmbajtjesore, edhe thjesht të bazohet në realitet. “Realiteti është se Ramush Haradinaj është i ndaluar me një fletarrest të fabrikuar, të keqpërdorur, Serbia me këtë rast ka keqpërdorur edhe institucionet ndërkombëtare, Interpolin, që Franca, shteti ynë mik thjesht i ka procedurat e veta legjitime në trajtimin e çdo rasti të tillë. Kemi edhe raste kur edhe ish-komandant tjerë të UÇK-së kanë pasur të njëjtin fat, jo kështu, jo në këtë masë të stërzgjatje, por thjeshtë kanë kaluar nëpër procedura të njëjta, z. Thaçi, z. Çeku, pastaj shteti ynë mik Bosnja përmes Ejup Ganiqit, 7-8 muaj, njerëzit tanë në Shqipëri, prandaj askush nuk ka ndonjë qëllim, mirëpo të jetë sa më e fuqishme. Prandaj, mendoj që teksti përfundimtar duhet për t’u votuar, me këto ndryshime”, ka shtuar kryesuesi Ibishi.

**Sokol Bashota**, të përmirësohet “arrestimi” dhe ndalja”. “Te pika e gjashtë le të përmirësohet, se Franca është duke e zbatuar ligjin e vet. Raste të tilla me figura tona kemi pasur edhe në Shqipëri, edhe Shqipëria i ka ndaluar 4-5 ditë. Serbia e ka shfrytëzuar atë afatin ligjor prej 40 ditëve për ta bërë kërkesën e ekstradimit, ndërsa më herët për dy ditë e ka bërë në Shqipëri, e ka bërë për Agim Çekun, për Hashim Thaçin, për Ramushin po ashtu më herët, edhe shtetet përkatëse i kanë liruar si rezultat i procedurave të veta. . Këtu Interpoli ka rënë pre e Serbisë me këto lista. Pra le del mirë që të, sepse është një dokument që lexohet dhe do të bëhet publike”, tha Kryetari.

**Qamile Qitaku**, tha se jam kundër përdorimit të një fjalori populist. “Meqenëse ne jemi institucion publik, nuk na bën nder kur janë çështjet juridike të shprehemi me një fjalor populist. Ne e dimë gjithë çka mendojmë, mirëpo mendova që krejt problemet janë te Interpoli. Domethënë është mirë meqenëse të njëjtin punë e bën Presidenti, Qeveria, do të kishte qenë mirë që t’i bashkëngjitmi iniciativës së Qeverisë dhe Presidentit për tërheqjen e kërkesës në Interpol, domethënë kërkesës së vjetruar prej kohës së Millosheviqit. Meqenëse në atë orientim nëse ne shkojmë me kësi fjalori populist qysh jemi mësuar, më të vërtetë ato janë çështje juridike, mund të na merren si presione, si fjalor populist të gjitha ato. Kur e ka të njëjtin efekt, në këtë rast problematike është kërkesa e Interpolit”, ka theksuar anëtarja Qitaku.

**Tunë Dedaj**, tha se pari kisha për t’i falënderuar gjithë asamblistët që e përkrahin një deklaratë të këtillë. “Unë e di që Ramush Haradinaj ka qenë bashkëluftëtar edhe i kryetarit të Komunës, edhe i Fadilit, unë kisha për të propozuar që ajo deklaratë të rregullohen gjuhësisht, se gabimet gjuhësore janë në pyetje prandaj le të

përmirësohem. Pajtohem me Fadilin që s'ka asnjë problem tjetër të hiqen ato çka janë të tepërta të thëna, mirëpo me rëndësi për t'u votuar dhe debatuar shumë, se ne jemi për përkrahje”, tha anëtari Dedaj.

**Ndue Shabanaj**, tha se ne i patëm vërejtjet tona kur e shqyrtuam dhe kur e analizuam këtë deklaratë. “Por sipas vërejtjeve që i patëm ne si grupe aty, na dilte që duhej për ta rishkruar edhe një herë. Edhe nuk e patëm fort gatishmërinë e plotë, më shumë të Tunës, edhe e morëm si kompromis menjëherë për ta prurë në Kuvend. Unë mendoj që “ndalja” nuk e ka vendin absolutisht, “ndalim” është diçka tjetër “ndalje” është diçka tjetër. Ndalja mund për të qenë edhe personale, ndërsa ndalimi është i dhunshëm, kjo është një. Ne e thamë aty, mirëpo nuk e kemi ndryshuar. Edhe këtu ku po thuhet për shembull nën 6. Për 7-shin kemi qenë shumica për të mos qenë ose për ta riformuluar 7-shin, se nuk është konflikti në mes të institucioneve lokale dhe qendrore, kjo është më se e qartë. Pika 6 ka mundësi të riformulohet me një ndryshim të vogël.

“Shqyrtojnë rastin Haradinaj, gjegjësisht të mos lejohet keqpërdorimi i Interpolit nga ana e Serbisë”. Jo të “ndërpritet”, por “të mos lejohet”. Edhe kjo pika 7 nuk ka nevojë për të ekzistuar”, ka shtuar prof. Shabanaj.

Kryesuesi vuri në miratim Deklaratën.

**Me vota unanime u miratua Deklarata me rastin Haradaniaj.**

**Pika e dymbëdhjetë: Pyetje dhe përgjigje të këshilltarëve.**

**Sokol Bashota**, iu përgjigj interesimeve të këshilltarëve të KK rreth përdorimit të substancave narkotike në shkollat e mesme të Klinës. “Në një seancë të mëparshme është diskutuar rreth elementëve destruktiv që janë brenda shkollës si përdorues të drogës dhe substancave të narkotikëve nga nxënësit e shkollës. Një raport që ka dhënë policia rezulton kështu. Dua ta falënderoj Komandantin që është këtu prezent dhe gjithë stafin që e ka prurë në pika të shkurtra vetëm si statistika, me emra nuk janë. Si rezultat i punës dhe aktiviteteve policore për vitin 2016 në stacionin policor në Klinë janë iniciuar 15 raste posedimi ilegal i narkotikëve. Një rast kultivim i bimëve narkotike, si dhe një rast intoksim i personit tjetër me narkotik ose substanca psikotrope. Janë arrestuar gjithsej 22 persona, 20 janë nga Komuna e Klinës, 1 nga Komuna e Prizrenit dhe 1 nga Komuna e Gjakovës. Personat në fjalë janë recitivistë janë të veprave me narkotikë dhe janë të njohur për policinë, vetëm një person është ish- nxënës edhe ai nuk është nxënës i shkollës së mesme të Klinës. Të gjitha rastet janë raportuar dhe janë dërguar në prokurorinë e shtetit. Pas këtij raporti nuk do të thotë që këta nuk kanë për të punuar rreth këtij rasti që është shumë i ndjeshëm, por që fatbardhësisht edhe kështu është shumë alarmante të paktën jo në institucionet brenda shkollës. Rasti që ka qenë i raportuar këtu, që është potencuar këtu, jemi marrë personalisht me këtë rast, ato kanë qenë tre vajza të cilat kanë pirë cigare, gjegjësisht vetëm njëra ka pirë cigare, por jo narkotik, kështu deri me tash kështu është gjendja”, ka sqaruar kryetari Bashota.

**Filloreta Berisha**, tha se falënderoj kryetarin për informim, ashtu qysh e kemi kërkuar edhe informacionin, edhe i gëzohem faktit që nuk kemi në bazë të raporteve nuk kemi më shumë përdorues se sa ky numër, normalisht që edhe ky numër është shqetësim. “Urojmë që të mos kemi këtë vit edhe tutje kemi për të pasur numër edhe më të ulët të tyre. Sa për informim unë nuk e kam marrë krejt rastësisht edhe krejt normal se i gëzohem faktit për të pasur sa më pak raste të tilla Klina, por menjëherë pas një jave sa unë kam kërkuar unë këtu, që nuk kam dashur të keqkuptohem sikur atë ditë, por për ta marrë në mënyrë normale si shqetësim i qartë edhe për ta marrë më me qetësi. Domethënë me datën 2 shkurt 2017 menjëherë në gazetë ka dalë që në QKMF të Klinës ka dalë që pacienti kapet me substancë narkotike. Domethënë ka pasur do informacione se ka substanca që po sillen nëpër nxënës, megjithatë sido kudo është raport edhe e përkrahi raportin edhe urojmë që të kemi sa më pak raste të tilla”, ka shtuar Dr. Berisha.

**Sokol Bashota**, tha se kjo nuk e mbyll punën, ata veç e kanë marrë seriozisht shqetësimin e AK dhe të gjithëve.

**Petrit Palushi**, tha se kam një kërkesë, desha që në seancën tjetër nëse ka mundësi të na sillen analizat e ujët për vitin 2017 nga Instituti i Shëndetit Publik, edhe mostrat le të merren nëpër institucione publike, domethënë në komunë, nëpër shkolla, ambulanca etj., e jo vetëm te fabrika e ujët.

**Sokol Bashota**, tha se në bashkëpunim me qeverinë zvicerane, domethënë me 1 mars fillon rregullimi aty ku është rrjeti i shtrirë nëpër shtatë fshatra, prandaj mendoj se është duke u rritur gama e investimeve të qeverisë zvicerane, edhe në momentin kur veç përfundojnë, që kanë filluar prej fabrikës, pusit të Jerinës, nëpër fshatrat në të cilët janë shtrirë disa rrjete janë duke u implementuar, edhe me Sferkë, edhe Volljakun, më duke edhe Berkova, në Resnik etj. Për analiza e kanë një kontratë me cilin institut i nuk e di se me cilin, megjithatë ato do të kryhen doemos”, ka theksuar kryetari Bashota.

**Lorenc Marleku**, tha se unë në dy seancat e kaluara kam ngritur një shqetësim, gjegjësisht një kërkesë për tabelat orientuese në hyrje dhe dalje të Klinës. “Nuk më është dhënë përgjigje tash pyet kryetarin çka po bëhet me to, me sigurisht se nuk është çështja te buxheti, sepse aty janë vetëm 3-4 tabela orientuese në hyrje dhe dalje të Klinës, që është shqetësim për qytetarët, edhe pse nuk bëhen”?- ka shtruar pyetjen anëtari Marleku.

**Kolë Prenaj**, sqaroi çështjen e ngritur nga anëtari Marleku. “Jemi dëshmitarë të asaj që ne jemi me investime në qendër të Klinës. Kjo shkon në bashkëpunim me Drejtorinë e SHP dhe Sektorin e Policisë. Ka ndërhyrje, edhe ma merr mendja që së shpejti do të bashkëpunojmë mese vete dhe do t’i kryejmë”, sqaroi drejtori Prenaj.

**Arben Limani**, tha se vitin e kaluar në emër të grupit e patëm ngritur çështjen e gjendjes në shtëpinë e kulturës, domethënë të kalimit pa u kryer të gjitha punët e stafit aty. “Dhe, mund të them se gjatë gjithë dimrit, bile gjatë asaj kohës sa ka mbretëruar tepër ftohtë stafi aty nuk ka punuar fare. Domethënë nuk funksionon nxehja, edhe s’kanë mundur punëtorët për të qenë të pranishëm as në bibliotekë, as arkiv. Domethënë shqetësimi që patëm ngritur që stafi është instaluar aty pa u kryer të gjitha punët mirë, veç po del se pjesa më e madhe, bile kalon dimri krejt edhe punëtorët nuk kanë mundësi për ta kryer punën e tyre”, ka theksuar anëtari Limani.

**Vlora Tafili**, tha se si asambliste kam një shqetësim, por nga komiteti ku unë jam anëtare për shërbimë publike po vjen si vërejtje për drejtorin e Urbanizmit, z. Baki Gashi. “Ky nuk ka marrë pjesë në takimin tonë më datë 15, këtë të mërkurë, ka qenë kërkesa e qytetarëve për infrastrukturë. Është mbledhja e tretë e këtij komiteti që drejtori nuk vjen edhe nuk është serioz, domethënë nuk respekton komitetin as qytetarët, gjë që e kam për obligim me ligj për të qenë bashkëpunues. Kështu që bashkë me këtë vërejtje kisha lutur drejtorin për të marrë pjesë në këto takime dhe për të qenë i vetëdijshëm për përgjegjësitë që i ka”, tha anëtarja Tafili.

**Kristina Lazri**, iu përgjigj çështjes së ngrehur nga anëtari Limani. Sa i përket temës rreth shtëpisë së kulturës ne edhe e kemi diskutuar. “Është e vërtetë që ka problem me nxehje qendrore, por nuk është e vërtetë që punëtorët nuk kanë qenë në punë asnjë ditë, edhe pse në kushte mund të them në ato temperatura shumë të ultë. Do të thotë kanë qenë, ndoshta ndërkohë kanë dalë nga pak sa për t’u ngrohur, se më të vërtetë kanë qenë temperaturat shumë të ultë, mirëpo kanë punuar çdo ditë. Nuk është problemi tek ne, çështja e nxehjes është një problem te tafalet që KEDS-i po neglizhon në rregullimin e saj, po na kërkon disa kriteret tjera për shkak të objektit. Për momentin rryma ka një kapacitet të ulët që nuk mund të funksionon nxehja. Kështu që po presim që kërkesa që kemi bërë në KEDS të na miratohet, edhe tafalet të lëshohet dhe besoj që për vitin e ardhshëm do të jetë në rregull”, sqaroi drejtoresha Lazri.

**Skënder Meturi**, tha se kjo është seanca e tretë e shqetësimit lidhur me shpjegimet që ende nuk i kam marrë. “E para, që e kemi diskutuar disa herë edhe në KPF kur kam qenë, për prona, që një listë të pronave të Komunës nuk e kemi marrë ende, edhe nuk i dimë çështjet e tyre, e para, edhe e dyta, ende nuk e kam marrë një përgjigje me shkrim, po e theksoj, me shkrim, lidhur me vendosjen e fotografisë të ashtuquajturit President. Thjesht, po kërkoj shpjegim për këto gjera, edhe do të vazhdoj për të kërkuar edhe në seancat tjera shpjegim për këto dy çështje derisa nuk marr një shpjegim”, tha Merturi.


**Sokol Bashota**, tha se ose fotografinë e Presidentit Thaçi, ose të Nikoliqit, është shprehur kryetari Bashota.

Kryesuesi falënderoi për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 14:10 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Kuvendit,  
Dr. Haxhi IBISHI

